# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6896
E martë, 16 maj 2023
Çmimi 0.40 €


## Erdogani dhe Kilicdaroglu shkojnë në balotazh

FAQE 2





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


PARTIA SOCIALISTE SHËNON FITORE TË THELLË NË ZGJEDHJET LOKALE NË SHQIPËRI

# SHQIPËRIA BËHET ROZË, PS-ja FITON ZGJEDHJET PËRBALLË OPOZITËS

FAQE 4-5



Partia Socialiste (PS) e Edi Ramës ka "poshtëruar" koalicionin "Bashkë Ftojmë" të kryesuar nga Sali Berisha dhe Ilir Meta, duke shënuar fitore të thellë në zgjedhjet lokale në Shqipëri. Sipas rezultateve, PS-ja pritet t'i udhëheqë 54 bashki, ndërsa koalicioni i Berishës dhe Metës vetëm gashtë sosh. Kandidatët e partisë së Ramës kanë fituar edhe në bastionet tradicionale të demokratëve. Një prej tyre është Shkodra. Berisha dhe Meta i kanë humbur zgjedhjet edhe në vendlindjet e tyre, në Tropojë dhe në Skrapar

## KOMUNAT I BËJNË SHTATË KËRKESA KURTIT, PRESIN REAGIM TË SHPEJTË

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Agim Aliu, ka kërkuar vëmendje më të madhe të qeverisë Kurti në raport me kërkesat që kanë komunat. Aliu ia ka lexuar të hënën kryeministrit Kurti shtatë kërkesat që kanë parashtruar komunat për qeverinë. Ai ka theksuar se këto kërkesa vazhdimisht ia kanë adresuar qeverisë, por deri më sot nuk kanë marrë përgjigje për zgjidhjen e tyre FAQE 3



## AKTUALE



### DEPUTETI DUGOLLI, EDHE NJË SHKRESË PËR SPECIALEN QË TA HETOJË MASAKRËN E DUBRAVËS F. 7

### SPAHIU: PROJEKT-STATUTI I PROPOZUAR PËR ASOCIACIONIN CENON PARIMET E PAVARËSISË SË KOSOVËS F. 7

### VELIU: LLAPI NUK E MERITON NJË KRYETAR KOMUNE ARROGANT, AS LDK-JA NJË KRYETAR QË NUK GUXON TË FLASË F. 7

## EKONOMI



### NË ITALI PARAQITET POTENCIALI EKONOMIK I KOSOVËS F. 8

### QEVERIA THOTË SE KOMUNAT E PREKURA NGA VËRSHIMET SË SHPEJTI PRITET TË KOMPENSOHEN F. 8

## SPORT



### SONTE MËSOHET FINALISTI I PARË I LIGËS SË KAMPIONËVE F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Erdogani dhe Kilicdaroglu shkojnë në balotazh




ANKARA, 15 MAJ - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan, i cili e ka udhëhequr Turqinë për 20 vjet, do të përballet në raundin e balotazhit me kundërkandidatin e tij opozitar, Kemal Kilicdaroglu.
Votimet për zgjedhjet presidenciale do të mbahen më 28 maj, pasi në raundin e parë asnjëri nga kandidatët nuk fitoi mbi 50 për qind të votave.
Sipas Këshillit Suprem Zgjedhor, Erdogani në raundin e parë të zgjedhjeve fitoi 49.51 për qind të votave, ndërkaq Kilicdaroglu 44.88 për qind.
Raundi i balotazhit do të përcaktojë nëse shteti i Turqisë, aleat i NATO-s, mbetet nën kontrollin e Erdoganit ose rifillon një rrugëtim më demokratik, të premtuar nga lideri i opozitës, Kemal Kilicdaroglu.
Para publikimit të rezultateve nga autoritetet zgjedhore, Erdogani iu drejtua mbështetësve të tij në Ankara. Ai tha ende mund të fitonte, porse do ta respektonte vendimin e qytetarëve nëse gara shkon drejt një balotazhi pas dy javësh. “Ne ende nuk e dimë nëse zgjedhjet përfunduan në raundin e parë... Nëse kombi ynë ka zgjedhur për një rund të dytë, kjo është e mirëpritur", tha Erdogani në mëngjesin e së hënës, duke vënë në dukje se është duke vazhduar numërimi edhe i votave të qytetarëve turq që jetojnë jashtë vendit.
Ai mblodhi 60 për qind të votave të diasporës në vitin 2018.
Turqia më 14 maj mbajti zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. Këto zgjedhje u përqendruan kryesisht në çështjet e brendshme si ekonomia, të drejtat civile dhe tërmeti i muajit shkurt që la të vdekur më shumë se 50 000 njerëz. "Ne do të fitojmë absolutisht raundin e dytë dhe do të sjellim demokracinë", tha Kilicdaroglu, 74 vjeç, kandidat i një aleance prej gjashtë partish, duke argumentuar se Erdogani kishte humbur besimin e një kombi që tani kërkon ndryshim.
Më shumë se 64 milionë njerëz, përfshirë votuesit jashtë shtetit, kishin të drejtë vote në zgjedhjet e 14 majit dhe gati 89 për qind e tyre votuan.
Pjesëmarrja e votuesve në Turqi është tradicionalisht e madhe pavarësisht se qeveria ka shtypur lirinë e shprehjes dhe tubimet përgjatë viteve, posaçërisht që nga një përpjekje për grusht-shtet në vitin 2016.
Në nivel ndërkombëtar, këto zgjedhje u panë si një test i aftësisë së një opozite të bashkuar për të larguar një lider që ka përqendruar pothuajse të gjitha fuqitë shtetërore në duart e tij dhe ka punuar për të ushtuar më shumë ndikim në skenën ndërkombëtare.

# Franca premton më shumë ndihmë ushtarake për Ukrainën





Paris, 15 maj - Franca premtoi ndihmë ushtarake shtesë për Ukrainën të dielën, duke përfshirë tanke, automjete të blinduara, trajnime për ushtarët dhe ndihma të tjera, në kohën kur ushtria ukrainase po përgatitet për një kundërsulm ndaj forcave ruse. Ky lajm u dha pas bisedimeve të paparalajmëruara në Paris ndërmjet dy liderëve.
Volodymyr Zelensky i Ukrainës dhe Emmanuel Macroni i Francës zhvilluan një takim përreth tri orë në Pallatin presidencial francez Elysee - një takim që u mbajt i fshehtë deri pak para mbërritjes së liderit ukrainas në Paris nga Gjermania, me një avion të qeverisë franceze.
Ndihma ushtarake për Ukrainën ishte një nga pikat kryesore të agjendës së takimit ndërmjet liderëve.
Zyra e Macronit tha se Franca do ta furnizojë Ukrainën me dhjetëra tanke të lehta dhe automjete të blinduara “në javët në vijim”, pa dhënë numra specifikë. Gjithashtu, u premtuan më shumë sisteme të mbrojtjes ajrore, por përsëri detajet nuk u bënë publike.
Franca synon të trajnojë rreth 2 000 ushtarë ukrainas në Francë këtë vit dhe gati 4 000 të tjerë në Poloni si pjesë e një përpjekjeje më të gjerë evropiane për t’i dhënë ndihmë Ukrainës, tha zyra e Macronit.
Në një deklaratë, Franca e përshkroi mbështetjen e saj për pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës si “të palëkundur” dhe premtoi se ndihma e saj politike, ekonomike, humanitare dhe ushtarake do të vazhdojë “për aq kohë sa të jetë e nevojshme”.
Në një postim në “Twitter”, pas mbërritjes së tij, Zelensky tha: “Me çdo vizitë, aftësitë mbrojtëse dhe sulmuese të Ukrainës po zgjerohen. Lidhjet me Evropën po forcohen dhe presioni ndaj Rusisë po rritet”.
Franca e ka furnizuar Ukrainën me një sërë armatimesh, duke përfshirë sisteme të mbrojtjes ajrore, tanke të lehta, armë të tjera, pajisje dhe karburante.

## Zelensky takon edhe kryeministrin britanik

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, pas vizitës në Francë, ka mbërritur në Britaninë e Madhe për t’u takuar me kryeministrin britanik Rishi Sunak. “Gëzohem që takova sërish kryeministrin e Mbretërisë së Bashkuar, Rishi Sunak. Ne vazhdojmë të punojmë për fitoren e Ukrainës”, ka shkruar Zelensky në “Facebook”.

EPOKA E RE
Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI ME DISA MINISTRA KA MBAJTUR TAKIM ME KRYETARËT E KOMUNAVE

# Komunat i bëjnë shtatë kërkesa Kurtit, presin reagim të shpejtë



Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Agim Aliu, ka kërkuar vëmendje më të madhe të qeverisë Kurti në raport me kërkesat që kanë komunat. Aliu ia ka lexuar të hënën kryeministrit Kurti shtatë kërkesat që kanë parashtruar komunat për qeverinë. Ai ka theksuar se këto kërkesa në vazhdimësi ia kanë adresuar qeverisë, por deri më sot nuk kanë marrë përgjigje për zgjidhjen e tyre

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 15 MAJ - Kryeministri Albin Kurti ka mbajtur të hënën një takim koordinues ndërmjet anëtarëve të kabinetit qeverisës dhe kryetarëve të komunave me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe zgjerimit të mëtutjeshëm të komunikimit ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal.

Kurti ka thënë se takimet koordinuese në mes të nivelit qendror dhe atij lokal janë takimet ku ka më së shumti përfaqësues të qytetarëve, rrjedhimisht edhe temat të cilat trajtohen janë më të dobishmet dhe kanë fokus përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë.

Kryeministri në këtë takim kryetarëve të komunave u foli edhe për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. "Krahas bashkëpunimit në fushën e mjedisit, në kuadër të 'Kartës së Komunës së Gjelbër dhe të Qëndrueshme' dhe atë të efiçiencës së energjisë, në kuadër të pakos 75-milionëshe për përballje me krizën energjetike, më lejoni të theksoj se është lajm i mirë për të gjithë kandidimi i vendit tonë për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Një ngjarje e tillë, përveçse mundësi e mirë për ta përmirësuar infrastrukturën publike, paraqet një platformë ideale për afirmim të shtetit tonë në arenën ndërkombëtare. Për këtë arsye, Lojërat Mesdhetare nuk janë vetëm një projekt i sektorit të sportit. Ato duhet të shikohen si projekt zhvillimor shtetëror dhe mobilitet për rininë tonë", është shprehur ai, duke shtuar se koncepti i organizimit të këtyre lojërave në Kosovë parasheh shtrirjen e organizimit në tërë territorin e Kosovës, duke përfshirë investimin dhe mobilizimin në shumë komuna, me theks të veçantë në shtatë komunat më të mëdha në vend. "Ditët në vazhdim ekipi koordinues i kandidaturës së Kosovës do t'ju kontaktoj dhe do t'ju informojë më shumë për konceptin dhe për detajet e tjera të ndërlidhura me projektin", ka deklaruar Kurti.

Ai ka theksuar se herën e fundit u takuan për të diskutuar një temë specifike, atë të energjisë së ripërtërishme ndërsa, sipas tij, në këtë takim nga Asociacioni i Komunave janë listuar disa tema, të cilat janë me rëndësi për nivelin lokal, që nga tatimi në pronë, pronat e administruara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Agjencia e Pyjeve e deri te buxheti i komunave dhe procedurat e rekrutimit në shërbimin publik. "Për të gjitha këto, natyrisht edhe për tema të tjera të ngjashme, unë jam këtu sot bashkë me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqin, ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, dhe zëvendësministrin e Punëve të Brendshme, Bardhyl Dobra, që të bashkëbisedojmë dhe të diskutojmë drejt zgjidhjeve", ka thënë Kurti.

Kryeministri bëri me dije se para tre javëve Komisioni i Granteve ka mbajtur një takim të rëndësishëm, në të cilin është miratuar ndarja e granteve për komuna për periudhën 2024-2026. "Buxheti i përgjithshëm komunal për vitin e ardhshëm arrin vlerën prej 742 milionë eurosh, që i bie gati 200 milionë euro më shumë buxhet për komuna gjatë kësaj qeverisjeje sesa asaj të mëparshme. Që do të thotë se qeverisja lokale e ka vëmendjen e nivelit qendror, por edhe financat që presin të konkretizohen përmes një bashkëpunimi mes të gjithë neve", ka thënë kryeministri Kurti.

Ndërkaq kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Agim Aliu, ka thënë se komunat përmes asociacionit kanë shprehur vazhdueshëm shqetësimet e tyre, duke i paraqitur në formë zyrtare, me shkresa e rekomandime konkrete, për të cilat kanë marrë zotimet se do të marrin përgjigje adekuate, por që deri më tani nuk kanë regjistruar ndonjë sukses domethënës. Po sipas Aliut, problemet janë aty, të pazgjidhura dhe të tilla do të mbesin pa mbështetjen e qeverisë. "Nga takimi që patëm këto ditë me kryetarët e komunave, më lejoni, të nderuar të pranishëm, t'ju vë në dijeni se dolën këto qëndrime e këto kërkesa parashtruar për qeverinë si: 1. Kundërshtimi për bartjen e përgjegjësisë së faljes së Tatimit në Pronë te komunat, sepse kjo cenon të hyrat vetjake nga të cilat varen në masë të madhe projektet kapitale në komuna; 2. Urgjentisht të barten mjetet e të hyrave vetjake në komuna, për momentin të pezulluara; 3. Të themelohet Granti IV që do të krijojë barazi financiare për komunat e Kosovës; 4. Kërkojmë përshpejtimin e nxjerrjes së akteve nënligjore (në bazë të Ligjit të ri për Zyrtarët Publikë) që rregullojnë procedurat e rekrutimit në komuna, me theks lejimin e listës pritëse në arsim dhe shëndetësisë; 5. Komunave t'u kthehen pronat nga AKP-ja, prona këto që janë përcaktuar dhe të shpallura nga komunat për interes publik e për të cilat komunat i kanë nisur procedurat e projekteve dhe kanë njoftuar me shkrim nivelin qendror; 6. Të krijohen mekanizma ligjorë për bartjen e pronave të menaxhuara nga Agjencia e Pyjeve për zhvillim të projekteve si dhe në raste të tjera të këtë shmangie të procedurave burokratike për dhënien e lejeve për zhvillim të projekteve komunale; 7. Të mos lejohet që Zonat Ekonomike në komuna të kalojnë në përgjegjësi të nivelit qendror, por të vazhdojnë të administrohen nga komunat", ka thënë Aliu, duke shtuar se këto janë çështje të natyrës më urgjente, të cilave bashkërisht presin t'u jepet drejtim nga qeveria.



PARTIA SOCIALISTE SHËNON FITORE TË THELLË NË ZGJEDHJET LOKALE NË SHQIPËRI

# Shqipëria bëhet rozë, PS-ja fiton zgjedhjet përballë opozitës

Partia Socialiste (PS) e Edi Ramës ka "poshtëruar" koalicionin "Bashkë Ftojmë" të kryesuar nga Sali Berisha dhe Ilir Meta, duke shënuar fitore të thellë në zgjedhjet lokale në Shqipëri. Sipas rezultateve, PS-ja pritet t'i udhëheqë 54 bashki, ndërsa koalicioni i Berishës dhe Metës vetëm gashtë sosh. Kandidatët e partisë së Ramës kanë fituar edhe në bastionet tradicionale të demokratëve. Një prej tyre është Shkodra. Madje Berisha dhe Meta i kanë humbur zgjedhjet edhe në vendlindjet e tyre, në Tropojë dhe Skrapar

EPOKA E RE Lirim GECI

TIRANË, 15 MAJ - Në Shqipëri Partia Socialiste është duke shkuar drejt një fitore shumë të thellë në të gjithë vendin. Ndonëse numërimi nuk ka përfunduar ende në 11 bashki të vendit, socialistët pritet ta marrin kontrollin e 54 qyteteve shqiptare, kundrejt vetëm gjashtë të fituara nga koalicioni "Bashkë Fitojmë", i përbërë nga demokratët e drejtuar nga ish-kryeministri Sali Berisha, Partia e Lirisë e Ilir Metës dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe Demokristianët.

Sipas rezultateve nga numri i votave në 50 bashki, PS-ja ka fituar 43 nga 61 sosh. Kandidatët për kryetarë ta bashkive të drejtuar nga Edi Rama deri më tani kanë triumfuar në Kamëz, Vorë, Elbasan, Pustec, Kolonjë, Librazhd, Dropull, Tropojë, Roskovec, Libohovë, Rrogozhinë, Këlcyrë, Gramsh, Belsh, Përmet, Delvinë, Selenicë, Tepelenë, Peqin, Poliçan, Devoll, Lushnjë, Bulqizë, Mat, Klos, Korçë, Kuçovë, Sarandë, Dibër, Skrapar, Cërrik, Patos, Prrenjas, Berat, Vau i Dejës, Mallakastër, Vlorë, Konispol, Maliq, Lezhë, Dimal, Mallakastër dhe Divjakë.

Po ashtu, kandidati i socialistëve për kryetar të Shkodrës, Benet Beci, pothuajse ka arritur ta mposhtë me një diferencë të madhe të votave kundërkadidatin e "Bashkë Fitojmë", Bardh Spahinë, duke shënuar fitore historike në këtë bashki, e cila ishte bastion i demokratëve.

Ndërsa koalicioni "Bashkë Fitojmë" ka triumfuar në Has, Mirditë, Pukë, Fushë-Arrëz, Memaliaj dhe në Himarë. Bashkia e Himarës është kthyer në një pikë të nxehtë pas arrestimit të kandidatit opozitar Fredi Beleri nën akuzat e shitblerjes së votës. Beleri rezulton të jetë fitues me një diferencë të vogël të votave kundrejt kundërkandidatit socialist.

Socialistët, po ashtu, kanë shtrirë influencën e tyre edhe në shumë zona të tjera të vendit që, po ashtu, kanë qenë të kontrolluara kryesisht nga e djathta. E vetmja bashki që nuk është fituar as nga e majta as nga e djathta është ajo e Finiqit, ku socialistët nuk kanë konkurruar, duke i lënë fushë të lirë përfaqësuesit të Partisë Mega, e cila mbështet kryesisht nga minoriteti grek.

Në Tiranë, kryetari aktual, Erion Veliaj, është duke kryesuar me mbi 40 mijë vota diferencë nga kandidati i koalicionit "Bashkë Fitojmë", Belind Këlliçi. Në Durrës, një qytet ku parashikohej garë e ngushtë, kandidatja socialiste Emiriana Sako është duke udhëhequr me më shumë se 55 për qind të votave, ose me një diferencë mbi 7 mijë vota ndaj kandidatit të opozitës, Igli Cara.

Në lidhje me rezultatet e zgjedhjeve kanë reaguar liderët kryesorë të partive politike shqiptare. Lideri i PS-së, Edi Rama, ka vlerësuar lart punën e palodhshme të socialistëve për rezultatin e thellë të këtyre zgjedhjeve kundrejt opozitës. "Superskuadra që organizon sondazhet, studion shifrat, analizon trendët e pjesëmarrjes, ndjek të dhënat e terrenit në kohë reale dhe projekton rezultatet me përafërsi mbresëlënëse në bazë algoritmesh shkencore. Ndërsa të tjerët paralajmërojnë fitoret nëper tribuna duke parë filxhanin e dëshirave të tyre dhe pastaj kur dalin rezultatet nga

# Abdixhiku vazhdon vizitat nëpër biznese: Duhet t'i promovojmë dhe fuqizojmë bizneset e vogla

**Prishtinë, 15 maj** - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka vazhduar vizitat nëpër bizneset në vend. Ai të hënën e ka vizituar "Farm Market", i cili ofron produkte ushqimore të kultivuara nga familjet dhe bizneset e vogla vendore. "Sot vizitova 'Farm Market', një thesar i veçantë. I drejtuar nga Yllka dhe Sokoli, një çift i përkushtuar që mishëron vetë shpirtin sipërmarrës në Kosovë, 'Farm Market' ofron produkte ushqimore të kultivuara nga familjet dhe bizneset e vogla vendore. Çdo produkt këtu, nga djathi e deri tek ajvari, nga reçeli e deri tek mjalti, ka një tregim unik për të treguar, një familje pas saj, një traditë që ruhet e kultivohet në secilën prej këtyre familjeve", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".
Ai ka pohuar se tregimet si këto kanë nevojë për mbështetje shtetërore. "LDK-ja e njeh mirë rolin vendimtar që këto biznese të vogla familjare luajnë në ekonominë kombëtare. Prandaj po flasim me to, siç dhe jemi të përkushtuar për të krijuar një mjedis ku ndërmarrje të tilla mund të arrijnë potencialet më të larta. Plani ynë parasheh, përtej ofrimit të granteve, aftësimit e formalizimit të prodhuesve të vegjël, dhe zhbërjen e gjithë burokracisë së letrave, që është bërë tashmë një mur i pakapërcyeshëm mes shtetit dhe bizneseve të vogla familjare", është shprehur Abdixhiku.
Ai ka thënë se vizita në "Farm Market" dhe biznese të tjera familjare gjatë dy javëve të fundit vetëm sa e kanë forcuar bindjen e adresës së tyre zhvillimore. "Ne duhet të mbrojmë, promovojmë dhe fuqizojmë bizneset tona të vogla. Ata janë shtylla kurrizore e komunitetit dhe ekonomisë sonë", ka deklaruar Abdixhiku.




kutitë, vazhdojnë filxhanosen nëpër ekrane me dëshpërimin e avazit bajat të regjimit, që u grabiti befasisht fitoren imagjinare me kthetrat e krimit", ka thënë Rama.

### Opozita e zhgënjyer me zgjedhjet në Shqipëri

Pas këtij rezultati, udhëheqësi i koalicionit "Bashkë Fitojmë", Sali Berisha, të hënën ka dhënë një deklaratë për medie. Ai është shprehur i zhgënjyes me situatën zgjedhore, duke hedhur akuza në drejtim të qeverisë për korrupsion dhe blerje votash. "Kjo është një ditë e vështirë, e rëndë për lirtë dhe të drejtat e qytetarëve shqiptarë. Është një moment agonie për vlerat demokratike në vend. Unë jam këtu për të dënuar me forcën më të madhe këtë farsë elektorale e karakterizuar nga alfa dhe omega e krimit elektoral dhe ordiner. Jam këtu për t'u bërë thirrje të gjithë përfaqësuesve të opozitës në komisionet e numërimit ta vazhdojnë detyrën me përkushtim pasi është në parimin dhe qëllimin tonë të bëjmë gjithçka për mbrojtjen e votës së qytetarëve shqiptarë", ka thënë Berisha.
Ndërsa kryetari i Partisë së Lirisë, Ilir Meta, i cili ishte pjesë e koalicionit "Bashkë Fitojmë", ka thënë se e zgjedhjet 14 majit janë asgjësuar. "Zgjedhjet vendore të 14 majit në Shqipëri u asgjësuan që pa filluar. Duke mos e regjistruar opozitën në mënyrë të paligjshme, duke hequr komisionarët dhe numëruesit e opozitës. Duke përdorur tatimorët për presion ndaj çdo biznesi, duke kërcënuar votuesit e opozitës me gojën e kryeministrit, për pasojat që do të kishin nëse votonin për opozitën. Por zgjedhjet u asgjësuan edhe në ditën e zgjedhjeve, me zhbërjen e elementit themelor të sigurisë në zgjedhje, që ishte identifikimi




elektronik i zgjedhësve, duke i kthyer qendrat e votimit në vende ku u dhunua hapur ligji dhe ku u ushtrua presion i pashembullt duke u mbushur me qindra drejtorë ministrish, sekretarë të përgjithshëm, drejtorë bashkie, administratorë komunash e nëpunës gjithfarësh, përfshirë dhe policë e banditë", ka shkruar Meta në "Facebook".
Meta ka thënë se populli shqiptar është më i madh se qeveria Rama. "Populli shqiptar është shumë më i madh sesa narkoqeveria, dhe demokracia dhe ndryshimi që ai meriton, është i pashmangshëm. Asnjë narkozgjedhje nuk mund ta mbajë peng lirinë dhe të ardhmen e shqiptarëve", ka shkruar Meta.

## Parandalohet një rast i kontrabandës në veri





**Mitrovicë, 15 maj** - Policia e Kosovës, gjegjësisht Njësia për Ndërhyrje të Shpejtë (NjNSh) e Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare - Veriu, në vazhdën e kryerjes së detyrave me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit dhe dukurive negative, ka shtuar aktivitetet për parandalim të veprimtarive penale në përgjithësi dhe kontrabandës në veçanti.
Gjatë patrullimit në fshatin Bistricë kanë vërejtur një automjet transportues/kamion me targa vendore i cili ishte duke lëvizur nga Republika e Kosovës në drejtim të Serbisë. Personi i dyshuar, porsa ka vërejtur njësinë policore, e ka braktisur automjetin duke e lënë atë të ndezur dhe është larguar në drejtim të panjohur.
Gjatë kontrollit të realizuar në automjet janë gjetur të ngarkuara lëndë drunore të cilat dyshohet se ishin të dedikuara për t'i dërguar në Serbi.
Lidhur me rastin janë ndërmarrë të gjitha veprimet për procedura të mëtutjeshme hetimore, ndërsa automjeti i përfshirë në rast është dërguar në SPMK - Leposaviq.

# Vazhdon fushata sensibilizuese "Bëhuni pjesë e Policisë së Kosovës"



**Rahovec, 15 maj** - Drejtoria Rajonale e Policisë - Gjakovë, respektivisht Stacioni Policor në Rahovec, ka vazhduar promovimin e fushatës sensibilizuese "Bëhuni pjesë e Policisë së Kosovës". Bazuar në planin e veprimit, janë zhvilluar aktivitete në të cilat u është bërë thirrje qytetarëve të komuniteteve pakicë për aplikim në konkursin e shpallur nga Policia e Kosovës. Kjo fushatë ka përfshirë takime me përfaqësuesit e komuniteteve, OJQ-ve, bashkësive lokale, forumeve rinore, takime me zyrtarët për barazi gjinore, takime me nxënës të shkollave etj.
Në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjakovë, respektivisht në kuadër të Stacionit Policor Gjakovë, Rahovec dhe Malishevë, po vazhdojnë takimet informuese me qytetarë dhe të interesuar, me qëllim që të inkurajohen sa më shumë pjesëtarët e minoriteteve për të aplikuar në konkursin e shpallur nga Policia e Kosovës, duke qenë një mundësi e mirë për të rinj e të rejat që t'i bashkohen Policisë së Kosovës. "Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha minoritetet", është bërë me dije në njoftimin për medie të Policisë së Kosovës.

# Totaj pret në takim ambasadorin hungarez: Mbështetja e bizneseve është ndër prioritetet tona



**Prizren, 15 maj** - Kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të hënën në takim ambasadorin hungarez Jozsef Bencze, me të cilin ka diskutuar për zgjerimin dhe forcimin e bashkëpunimit të bizneseve të të dyja vendeve, duke e rritur nivelin e importit dhe eksportit. "Krijimi i urave për bashkëpunim ekonomik do të ndikojë në joshjen e investitorëve potencialë të huaj që do të përkthehej në zhvillim ekonomik dhe hapje të vendeve të reja të punës", ka thënë Totaj.
Me këtë rast, ambasadori Bencze ka propozuar binjakëzimin e Prizrenit me një qytet hungarez, duke i paraprirë me bashkëpunim konkret mes universiteteve të qyteteve të dy vendeve, duke e rritur kështu numrin e studentëve që studiojnë në Hungari dhe shkëmbimit të tyre në përgjithësi. "Kemi bashkëpunim të mirë me komunën e Prizrenit, qytetin tim të preferuar, dhe duam të krijojmë një lidhje bashkëpunimi me bizneset e Prizrenit. Ne kemi hapur edhe konsullatë në Prizren dhe mendojmë t'i thellojmë marrëdhëniet në të gjitha fushat. 75 studentë të Kosovës studiojnë në Hungari, por dëshirojmë ta rritim këtë numër", u shpreh ambasadori Bencze.
Kryetari Totaj falënderoi ambasadorin Jozsef Bencze për këtë iniciativë, ndërsa premtoi se do të krijohet klima e duhur për takimin e biznesmenëve të Prizrenit me organet hungareze të biznesit.

## Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pyjeve mban ligjërata për mbrojtje të mjedisit në shkollat e Mitrovicës

**Mitrovicë, 15 maj** - Me qëllim të ngritjes së vetëdijes te qytetarët sa i përket mbrojtjes së ambientit, Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Pyjeve në komunën e Mitrovicës ka filluar mbajtjen e ligjëratave në shkollat e Mitrovicës për rëndësinë e ruajtjes së ambientit. Këto ligjërata po zhvillohen në bashkëpunim me OJQ "REC" dhe Shoqatën e Peshkatarëve Sportivë Rekreativë "Ibri".
Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Pyjeve, Egzon Sadiku, ka thënë se procesi i vetëdijesimit për mbrojtjen e mjedisit nëpër shkollat e Mitrovicës ka ardhur si rezultat i nevojës për një edukim më të madh sa i përket kësaj fushe. Ligjërues nga DMMP ishte udhëheqësi i Sektorit të Mbeturinave, Irfan Peci.
Procesi i ndërgjegjësimit do të vazhdojë edhe gjatë kësaj jave.



## Spahiu: Projekt-statuti i propozuar për Asociacionin cenon parimet e pavarësisë së Kosovës

PRISHTINË, 15 MAJ - Ish-ambasadori i Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Avni Spahiu, ka thënë për "Zërin e Amerikës" se projekt-statuti për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, i paraqitur më 2 maj në Bruksel, cenon parimet themelore të pavarësisë së Kosovës. "Lidhur me Asociacionin, të jetë një bashkim komunash që nuk rrezikon aspak sovranitetin e Kosovës, por që ju bën të mundur serbëve të Kosovës që ta pranojnë Kosovën si vendin e tyre", ka thënë ai.
Spahiu vlerëson se çfarëdo zgjidhje për të drejtat e pakicës serbe në Kosovë duhet të vlejë edhe për pakicat e tjera në rajon, përfshirë pakicën shqiptare - Luginën e Preshevës në Serbi. "Do të ketë zhvillime të tilla. Është e paevitueshme, madje lidhur edhe me pakicat e tjera që jetojnë ta zëmë në Serbi, Maqedoni dhe vende të tjera. Në njëfarë mënyre kjo hap 'Kutinë e Pandorës', që të ndodhin situata të tilla. Natyrisht gjendja e shqiptarëve në Luginën e Preshevës është, të mos e quaj alarmante, për shkak të një diskriminimi pasiv që po organizohet", është shprehur ai.
Spahiu aktualisht udhëheq Këshillin e Ambasadorëve të Kosovës, i cili, thotë ai, synon mbështetjen e vendit për realizimin e interesave shtetërore në marrëdhëniet ndërkombëtare. "Tanimë Kosova ka mbi 50 ish-ambasadorë që kanë shërbyer dhe që nuk janë më në shërbim. Ata duan që ta japin kontributin e tyre në aspektin e këshilldhënies dhe të mbështetjes pa pagesë të Ministrisë sonë të Jashtme apo të kujtdo qoftë që dëshiron t'i ketë shërbimet tona", ka thënë ai.
Në kuadër të bashkëpunimit që



Këshilli i Ambasadorëve i Kosovës ka me Këshillin e Ambasadorëve Amerikanë, në Prishtinë gjatë javës së kaluar kanë qëndruar tetë ish-ambasadorë amerikanë.

# Veliu: Llapi nuk e meriton një kryetar komune arrogant, as LDK-ja një kryetar që nuk guxon të flasë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 15 MAJ - Ish-kryetari i Podujevës, Agim Veliu, është shprehur i ashpër ndaj Shpejtim Bulliqit dhe Ekrem Hysenit. "Kur në një përballje televizive dalin një ish-përfitues i LDK-së dhe një mohues i LDK-së, aty veç debat të argumentuar nuk mund të ketë. Ndërsa kryetari mashtrues po i thoshte të vetëmashtruarit 'hajde flasim për projekte, se në politikë të kam mundur', opozitari çile gur gojën. Nuk i bënte goja t'ia numëronte mëkatet kryetarit manipulator, për dy vjet mashtrim të qytetarëve", ka shkruar Veliu në "Facebook".
Ai ka shtuar se opozitari inferior, që e mori timonin e LDK-së në Llap si dhuratë, nuk e tha asnjë fjalë të vetme për punët e projektet e mëdha të bëra për qytetarët e Llapit gjatë qeverisjes së LDK-së për dy dekada. "Asnjë kundërshtim ndaj krekosjeve të kryetarit mashtrues, i cili po lavdërohej me projektet e trashëguara nga qeverisja e LDK-së. Asnjë fjalë e argumentim konkret për abuzimet e vazhdueshme të kryetarit arrogant me qeverisjen dhe buxhetin e komunës. Dhe tash me të drejtë pyesin qytetarët, aktivistët, anëtarët e simpatizantët e LDK-së, çfarë deshi dhe cili ishte qëllimi i paraqitjes në një debat televiziv i kryetarit të kontrabanduar të LDK-së në Podujevë? Në qoftë se ka dashur ta dëshmojë edhe njëherë paaftësinë dhe inferioritetin politik përballë një mashtruesi të ardhur aksidentalisht në krye të komunës, atëherë ia ka dalë plotësisht, siç ia doli edhe kryetari manipulator ta dëshmojë paturpësinë politike, duke i numëruar si sukses projektet e trashëguara nga qeverisja e LDK-së", ka shkruar Veliu.
Deputeti i LDK-së, Agim Veliu, ka thënë se Llapi nuk e meriton një kryetar komune që arrogancën e ka si mjet komunikimi dhe mashtrimin e manipulimin si formë qeverisjeje. "As LDK-ja në Llap nuk e meriton ta udhëheqë një person indiferent e inferior, që nuk guxon të flasë për sukseset e qeverisjes së partisë, të cilën mëton ta përfaqësojë", ka shkruar Veliu.

## Deputeti Dugolli, edhe një shkresë për Specialen që ta hetojë masakrën e Dubravës

PRISHTINË, 15 MAJ - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Enver Dugolli, i është drejtuar edhe njëherë me një shkresë Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Hagë. Dugolli, i cili është i mbijetuari i masakrës së Dubravës, ka thënë se i ka ofruar argumente shtesë ushtruesit të detyrës së Prokurorit të Specializuar, Alex Whiting, se Gjykata Speciale ka juridiksion të plotë për ta hetuar këtë masakër. "Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, sot prapë i kam dërguar një shkresë u.d. prokurorit të specializuar, z. Alex Whiting. Kjo shkresë ofron argumente shtesë duke u bazuar në tri vendimet e lëshuara nga vetë Gjykata Speciale se i takon juridiksioni lëndor. Pra, Gjykata Speciale ka juridiksion lëndor mbi krimet e kryera të forcave serbe gjatë planifikimit dhe ekzekutimit të masakrës së Dubravës. Në bazë të argumenteve të parashtruara me këtë shkresë, nuk mbetet më asnjë dyshim: prokurori i specializuar ka juridiksion të plotë për ta hetuar këtë rast. Si viktimë dhe i mbijetuar i masakrës së Dubravës, nuk do të pushoj së kërkuari drejtësi", ka shkruar Dugolli në "Facebook".



## Qeveria thotë se komunat e prekura nga vërshimet së shpejti pritet të kompensohen

PRISHTINË, 15 MAJ - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka thënë se shumë shpejt pritet që komunat e prekura nga vërshimet si pasojë e reshjeve të dendura të shiut gjatë këtij viti të kompensohen. "Nga shtatori i vitit të kaluar qeveria ka marrë vendim për themelimin e një sekretariati. Tash e tutje kompensimet për të gjitha veprimtaritë do të ekzekutohen nëpërmjet këtij sekretariati. Ne kemi informatën se tashmë ekziston një raport final dhe është dërguar në Ministrinë e Financave dhe pritet që në njërën nga mbledhjet e qeverisë të ndodhë kompensimi", ka thënë Peci pas takimit që kryeministri Albin Kurti pati me kryetarët e komunave.

Komunat me dëmet më të mëdha materiale si pasojë e vërshimeve janë Mitrovica, Skenderaj dhe Klina. E deputeja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se nga janari kur kanë ndodhur vërshimet në komuna e deri më sot asnjë cent nuk e ka dhënë qeveria. "A e di kjo qeveri sa familje sot janë disa herë më keq ekonomikisht krahasuar me kohën e paravërshimeve. Si i kanë përballuar këta qytetarë këto pasoja? Çka thonë qytetarët e këtyre komunave kur të dëgjojnë se Kurti paska premtuar sot plus 200 milionë euro për komuna për vitin 2024", ka shkruar Bajrami në "Facebook".



# Në Itali paraqitet potenciali ekonomik i Kosovës

EPOKA E RE Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 15 MAJ - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë, Ambasadën e Republikës së Kosovës në Itali dhe Agjencinë e Tregtisë dhe Investimeve të Italisë, ka organizuar prezantimin e potencialit ekonomik të Kosovës në Itali dhe mundësitë për bashkëpunim ekonomik.

Kosova Country Presentation u mbajt në selinë qendrore të Agjencisë së Tregtisë dhe Investimeve të Italisë në Romë - "ICE", me ç'rast përfaqësuesit qeveritarë, ata të sektorit privat, asociacionet dhe bizneset prezantuan potencialin ekonomik dhe mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Italisë.

Hapja e kësaj ngjarjeje u bë nga zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Republikës së Kosovës, Liza Gashi, dhe nënsekretarja e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë, Maria Tripodi. Po ashtu, përmes një mesazhi këtë ngjarje e përshëndeti zëvendëskryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme i Italisë, Antoni Tajani. Përfaqësuesit nga të dyja qeveritë folën për të përbashkëtat e dy vendeve dhe për mundësitë e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar.

Zëvendësministrja Gashi në fjalën e saj ka theksuar se Kosova me zhvillimin e saj të fundit po bëhet gjithnjë e më e favorshme për investime në Evropën Juglindore, me popullsinë më të re në Evropë dhe një ekonomi me mundësi të rritjes së vazhdueshme. "Pozicioni ynë gjeografik bën që Kosova të jetë një vend i favorshëm për qëndrime afër, energji të rinovueshme, me një potencial për ta transformuar atë në një qendër transporti që lidh Lindjen dhe Perëndimin", ka thënë Gashi. Po ashtu, palët nga të dyja shtetet diskutuan për mundësitë e partneritetit ekonomik dypalësh në mes të Kosovës dhe Italisë.

Përfaqësuesit e të dyja vendeve potencuan rëndësinë e thellimit të marrëdhënieve miqësore në fushat me interes reciprok, veçanërisht sa i përket bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, dhe në fushën e teknologjisë së informacionit, me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit të shkëlqyer që Kosova ka me Italinë.

Në përmbyllje të kësaj ngjarjeje të pranishmëve iu drejtuan edhe ambasadorja e Republikës së Kosovës në Itali, Lendita Haxhitasimi, dhe ambasadori i Republikës së Italisë në Kosovë, Antonello de Riu. Ata i falënderuan të pranishmit, duke i informuar në lidhje me forumin ekonomik që pritet të mbahet në Prishtinë.

Delegacioni i Kosovës, i kryesuar nga zëvendësministrja Gashi, përbëhej nga përfaqësues të Presidencës, të qeverisë, nga sektori privat, si dhe nga përfaqësues të Shoqatës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës, nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës, Klubi i Prodhuesve të Kosovës dhe Shoqata e Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve të Kosovës, si dhe Shoqata e Biznesmenëve dhe Zejtarëve - Esnaf në Prizren.

## Peci: Objektet pronë e Ministrisë së Bujqësisë po përdoren kundërligjshëm

PRISHTINË, 15 MAJ - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka publikuar në "Facebook" pamjet e disa lokaleve afariste në qendër të Prishtinës, që thotë se janë pronë e ministrisë që ai udhëheq dhe që rasti është denoncuar prej shtatë muajsh. "Veprimtari që ushtrohet kundërligjshëm sepse s'ka se si të jetë ndryshe kur edhe kundërligjshëm janë ndërtuar e po në atë mënyrë vazhdojnë të funksionojnë", ka shkruar Peci. Ai ka theksuar se, përveç provave të deponuara në polici e prokurori, ndihmë rreth kësaj çështjeje ka kërkuar edhe nga kryetari i Prishtinës me të cilin janë pajtuar që ta ndërmarrë aksionin përmes inspektoratit. "Përkundër dakordimit, me gjasë nuk i ka pa edhe tri kërkesat e drejtuara përmes emailit, që ta lirojë pronën e Ministrisë dhe t'ia kthejë titullarit. Ata që i kanë lejuar dhe mundësuar këto veprimtari janë emra të përveçëm e që prokuroria ka fakte", ka thënë ministri Peci.



# Paradoksi i pushtetit. Çfarë e shkakton metamorfozën e udhëheqësve



Njerëzit janë një specie shoqërore, suksesi evolucionar i të cilëve është nxitur nga aftësia për të punuar së bashku. Nëpërmjet bashkëpunimit, ne kemi gjuajtur kafshë shumë më të mëdha se ne, jemi zgjeruar në çdo vend mjedisor, kemi nisur një revolucion teknologjik dhe madje kemi zbritur një njeri në Hënë – të gjitha brenda 200,000 viteve.

Ndërsa këto arritje ndahen nga i gjithë njerëzimi, nuk ka ndodhur e njëjta jë me përfitimet e tyre. Kjo sepse ne nuk evoluam për t'u bërë një specie egalitare, por një specie hierarkike. Pse?

Sipas etnografit dhe konsulentit të lidershipit Simon Sinek, lidershipi – dhe si pasojë statusi dhe pushteti – është një kompromis. Fisi u kërkon udhëheqësve t'i mbrojnë ata, të sigurojnë që të gjithë të marrin pjesën e tyre dhe të jenë të parët që sakrifikojnë veten për të mirën e të gjithëve. Në këmbim, fisi u bindet vendime të liderit dhe i siguron atij/asaj pjesën e luanit të burimeve.

Në të kaluarën e largët, kjo do të nënkuptonte më shumë mish, partnere dhe një jetë më e mirë për ata që janë përgjegjës. Edhe sot nuk ka ndryshuar shumë në këtë drejtim.

"Kjo është marrëveshja. Ky është përkufizimi antropologjik i lidershipit", thoshte Sinek në një intervistë. "Është gjithmonë e balancuar. Përfitimet e lidershipit nuk janë falas. Ato vijnë me koston e interesit vetjak. Ato vijnë me koston e kujdesit për ata që kemi në krye."

Sinek paralajmëron se ky shkëmbim vjen me një paralajmërim të rëndësishëm. Domethënë, disa liderë nuk e respektojnë pjesën e tyre të marrëveshjes. Në fakt, problemi është psikologjikisht më i thellë se lideri i padrejtë i radhës.

Ne duam udhëheqës të cilët janë të shoqërueshëm dhe që jetojnë sipas një kodi virtyti. Por edhe nëse gjejmë dikë që është i drejtë, i kujdesshëm dhe bashkëpunues, sapo t'i japim pushtetin, diçka ndryshon. Ata bëhen më të prirur të përfshihen në sjellje të vrazhda, egoiste dhe joetike, që i pasurojnë në kurriz të të tjerëve.

Psikologu Dacher Keltner e quan këtë "paradoksi i pushtetit" dhe ai e ka studiuar në mjedise të ndryshme si kampuset e kolegjeve, ekipet sportive, vendet e punës dhe, natyrisht, Kongresin e Shteteve të Bashkuara.

Por nuk janë vetëm CEO-t, liderët botërorë dhe yjet e sportit që bien pre e ndikimit të pushtetit. Jepini dikujt (ndokujt!) pak pushtet dhe ai/ajo ka më shumë gjasa të marrë më shumë nga kavanozi i biskotave të përbashkëta.

## Do të të kisha dhënë një biskotë (por e hëngra)

Ne priremi të mendojmë për pushtetin si shpërblim për ngjitjen në katet e sipërme të shkallëve shoqërore, por është gjithashtu shumë më i gjerë se kaq. Psikologët e përkufizojnë pushtetin thjesht si aftësinë e një individi për të ndikuar tek të tjerët edhe nëse ata përpiqen të rezistojnë. Keltner e ngushton pak këtë. Ai e konsideron pushtetin si aftësinë e një personi për të modifikuar gjendjet e të tjerëve, duke siguruar ose mbajtur burime ose duke dhënë ndëshkime. E rëndësishmja, këto burime nuk duhet të jenë materiale. Ato mund të përfshijnë njohuri, vëmendje ose dashuri.

Cilido qoftë përkufizimi që preferoni, të dyja sinjalizojnë se diskutimi i pushtetit nuk kufizohet vetëm tek politikanët, udhëheqësit organizativë dhe pasanikët e mëdhenj. Çdokush mund të përdorë pushtetin në kontekstin e duhur shoqëror – siç sugjeron studimi i ashtuquajtur "Përbindëshi i biskotave" i Keltner.

Ja si funksionon: Keltner dhe studenti i tij i atëhershëm Dan Ward fuan grupe të të njëjtit seks për të hartuar rekomandime politikash për çështjet sociale. Një anëtari të grupit iu dha pushtet rastësisht, për t'u dhënë pikë dy të tjerëve bazuar në performancën e tyre. Pas 30 minutash punë, sinqerisht, të mërzitshme, një eksperimentues do të sillte një pjatë me pesë biskota për një pushim të vogël. Kjo i lejonte dy persona të merrnin një biskotë shtesë ndërsa të tretin e linin pa biskotë.

Keltner dhe Ward zbuluan se individët me pushtet jo vetëm që kishin më shumë gjasa të merrnin një biskotë të dytë, por edhe t'i hanin biskotat e tyre në mënyrë më të çrregullt. Ata hanin me gojë hapur, përplasnin buzët dhe merakoseshin më pak se mos i binin thërrimet në këmisha.

Një studim tjetër i publikuar në Social Justice Research u përpoq të përsëriste rezultatet e Keltner dhe Ward. Këtë herë, studiuesit ofruan vetëm mjaftueshëm biskota për secilin pjesëmarrës sa për të marrë një, dhe, ofruan arsye për rolet e caktuara. Në varësi të grupit, ata i thanë pjesëmarrësit të autorizuar se iu caktua pozicioni i tyre për një arsye legjitime (të themi, aftësi), një arsye të jolegjitime (favoritizëm) ose pa arsye. Si më parë, pjesëmarrësit me pushtet e rrëmbenin një biskotë të dytë më shpesh. Është interesante se udhëheqësit e legjitimuar ose atyre të cilëve nuk u jepej asnjë arsye për rolin e tyre merrnin më shpesh një biskotë shtesë. Ata që e ndjenin pushtetin e tyre të paligjshëm hanin mesatarisht po aq biskota sa gjithë të tjerët.

## Fuqia për të ndryshuar zemrat dhe mendjet

Studimi Cookie Monster nuk është i vetëm në sugjerimin se pushteti ndryshon sjelljet sociale dhe etike të dikujt. Në një seri studimesh të botuara në Proceedings of the National Academy of Sciences, Keltner dhe psikologu Paul Piff eksploruan se si njerëzit me status më të lartë socio-ekonomik silleshin ndryshe nga ata me status më të ulët në situata të ndryshme.

Në eksperimentet e tyre laboratorike, ata që u identifikuan si të klasës së lartë u zbuluan se kishin më shumë gjasa të:

Mbështetnin sjellje joetike.

Gënjenin gjatë negociatave.

Mashtronin për të rritur shanset për të fituar.

Dhe merrnin karamele nga një kavanoz me karamele, edhe pasi iu tha se karamelet ishin për fëmijët në laboratorin ngjitur.

Jashtë laboratorit, studiuesit vëzhguan shoferët në një kryqëzim për të parë se si vepronin rreth automjeteve të tjera dhe këmbësorëve. Ata zbuluan se makinat që zakonisht lidhen me status të lartë (Mercedes ose BMW) kishin më shumë gjasa të prisnin rrugën e automjeteve të tjera dhe të mos e ulnin shpejtësinë në një vendkalim këmbësorësh sesa një Ford Taurus ose Pontiac Grand Am.

Psikologët supozojnë se arsyeja për sjellje të tilla antisociale është se pushteti ndryshon mënyrën se si ne lundrojmë dhe përjetojmë botët tona sociale. Na bën më të interesuar dhe të orientuar drejt qëllimit, gjë që mund të jetë një gjë e mirë (siç do ta shohim). Por nga ana tjetër, kjo na bën gjithashtu më pak të kujdesshëm, empatikë dhe të vëmendshëm ndaj rreziqeve – edhe kur pasojat e një basti të keq mund të prekin të tjerët.

Në një analogji, Keltner vuri në dukje se si njerëzit që dëmtohen në lobet frontale të trurit të tyre – një zonë e lidhur me ndjeshmërinë, vetëkontrollin dhe personalitetin – bëhen më të vrazhdë, më impulsivë dhe më të shkëputur nga të tjerët. "Studimet tona laboratorike zbulojnë se nëse u jep njerëzve pak pushtet, ata duken si pacientë me traum në tru," tha Keltner në kanalin YouTube të Universitetit të Kalifornisë. "Kur ndihesh i pushtetshëm, humb kontaktin me njerëzit e tjerë."

Ndërsa pushteti nuk shkakton tamam-tamam dëmtim të trurit, studimet sugjerojnë se ndryshon mënyrën se si truri ynë funksionon në situata sociale. Një studim monitoroi përgjigjet e trurit të pjesëmarrësve me një EEG ndërsa ata shikonin imazhe të shprehjeve neutrale ose shqetësuese të fytyrës. Ai zbuloi se pjesëmarrësit që u identifikuan si të klasës së lartë kishin një reagim të reduktuar ndaj dhimbjes së të tjerëve pavarësisht se vetë raportonin nivele më të larta të ndjeshmërisë. Një studim tjetër zbuloi se pjesëmarrës të tillë treguan më pak aktivitet nervor në një makinë fMRI kur përpiqeshin të "përjetonin" emocionet e dikujt.

## Lord Acton kishte të drejtë

Në këtë pikë, të dhënat duket se priren në drejtimin e aforizmit të Lord Acton: "Pushteti korrupton dhe pushteti absolut korrupton absolutisht". Në fakt, Acton shkroi se "pushteti tenton të korruptojë", gjë që është një dallim i rëndësishëm si për kuptimin e tij ashtu edhe për literaturën shkencore mbi pushtetin.

Si fillim, kërkimi mbi pushtetin është relativisht i ri dhe ka kufijtë e tij. Shumë nga këto studime kanë madhësi të ulëta të mostrës dhe është sfiduese të kontrollohen për shumë variabla të jetës, kur bëhet fjalë për gjëra të tilla si pushteti. Përpjekjet për të parë ndjenjat e pushtetit në një laborator, për shembull, mund të mos çojnë në të njëjtat ndjenja subjektive të fuqizimit të përjetuara nga të pushtetshmit në jetën e përditshme. Këto cilësi janë të vështira për t'u vlerësuar në mënyrë adekuate në një laborator ose nëpërmjet pyetësorëve.

Në mënyrë të ngjashme, treguesit e lidhur të pushtetit dhe statusit socio-ekonomik të përdorur në disa studime mund të ngatërrojnë rezultatet.

Së dyti, ne kemi injoruar gjysmën tjetër të monedhës së pushtetit: aftësinë e tij për të lartësuar gjithashtu tipare të virtytshme. Studimet kanë treguar se pushteti mund t'i ndihmojë njerëzit të bëhen më të sigurt, optimistë dhe krijues. Ai gjithashtu mund t'i ndihmojë njerëzit të kontrollojnë më mirë vëmendjen e tyre dhe të marrin rrezige – gjë që mund të jetë një tipar pozitiv kur rreziqet në fjalë janë të nevojshme dhe të matura.

Edhe Eksperimenti i Burgut të Stanfordit – një eksperiment famëkeq me vlerë të dyshimtë shkencore – tregon se marrëdhënia midis pushtetit dhe korrupsionit nuk është aq e qartë. Ai u përpoq të simulonte një mjedis burgu dhe të shqyrtonte se si dinamika e pushtetit ndryshoi sjelljen midis pjesëmarrësve "roje" dhe "të burgosur". Megjithatë, siç vëren psikologu Scott Barry Kaufman, jo çdo roje u deh në mënyrë abuzive me pushtetin. Disa ishin aktivisht të sjellshëm me të burgosurit, madje bënin porosi për ta dhe plotësonin kërkesa të dobishme.

"I vënë në përdorim të mirë, pushteti mund të ketë një efekt tepër pozitiv te njerëzit. Ka kaq shumë mësues, shefa, politikanë, humanitarë dhe të tjerë të dhembshur që zotërojnë pushtetin, të cilët vërtet duan ta bëjnë botën një vend më të mirë", shkruan Kaufman në Revistën Greater Good.




Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Sonte mësohet finalisti i parë i Ligës së Kampionëve

**Milano, 15 maj (ER)** - Një javë pas gëzimit të madh për fitoren në ndeshjen e parë gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve, Interi synon që sonte (e martë) ta përfundojë punën kundër rivalëve të qytetit, AC Milan. “Nerazzurri” ka dy gola epërsi dhe është më afër ta sigurojë finalen e madhe që zhvillohet muajin e ardhshëm, derisa në anën tjetër as “Rossonerët” nuk do të dorëzohen dhe do ta kërkojnë përmbysjen. Interi nuk pati sezon edhe aq të mirë në Serinë A, por në ndeshjet e fundit po arrin rezultate të mira dhe në përballjen e parë arriti fitore me dy golat e shënuara nga Edin Dzeko dhe Henrikh Mkhitaryan.

Milan Skriniar dhe Joaquin Correa janë dy mungesat e Interit për këtë ndeshje shumë të rëndësishme, derisa Milani do të jetë pa Junior Messias, Rade Kruniq dhe Ismael Bennacerin. Lajm i mirë për kuqezinjtë është rikthimi i Rafael Leao. Në fundjavë Interi konfirmoi formën e mirë ku fitoi ndaj Sassuolos me rezultat 4-2. Tash kjo skuadër renditet në pozitën e katërt me 66 pikë, një pikë më shumë se Milani. Kuqezinjtë pësuan humbje nga Spezia me rezultat 2-0. Fituesi nga kjo ndeshje në finalen e Stambollit përballet me fituesin e ndeshjes Manchester City - Real Madrid, e cila zhvillohet të mërkurën në mbrëmje.

**FORMACIONET E MUNDSHME:**

**Inter:** Onana; Darmian, Acerbi, Bastoni; Dumfries, Barella, Calhanoglu, Mkhitaryan, Dimarco; Martinez, Dzeko.

**Milan:** Maignan; Calabria, Tomori, Kjaer, Hernandez; Tonali, Pobega; Diaz, Leao, Saelemaekers; Giroud.





# Distria Krasniqi renditet e para në botë

**Prishtinë, 15 maj** - Xhudistja Distria Krasniqi është renditur e para në botë. Kështu tregon renditja e re e publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Xhudos. Krasniqi në kategorinë deri në 52 kilogramë ka marrë 7 mijë e 275 pikë. Pas saj është renditur xhudistja britanike Chelsie Giles, e cila ka marrë 7 mijë e 10 pikë. E treta është japonezja Uta Abe, e cila i ka 6 mijë e 800 pikë. Distria Krasniqi në Lojërat Olimpike “Tokyo 2020” ka arritur ta fitojë medaljen e artë. Ajo, po ashtu, në disa Kampionate Evropiane dhe Botërore është stolisur me disa medalje, të arta, të argjendta dhe të bronzta. “Për një ditë të mirë... Pamje e bukur për vendin tonë. Rezultatet në shumë gara Distrian e ngritin në pozitën e parë në ranglistën Botërore! E arta në World Judo Mastersin e Jerusalemit dhe Grand Slamin e Parisit si dhe medalja e Botërorit 2022 dhe medaljet e tjera janë sukseset që garuesen tonë e bëjnë lidere në ranglistën Botërore. Kjo pamje tregon që Kosova jonë e vogël është mbi të gjitha...”, ka shkruar Kuka në “Facebook”.

# Zeka: Çmimi u dedikohet ‘Skifterave’

**Prishtinë, 15 maj** - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i javës”. Ky çmim për javën e 34-t në elitë i ka takuar futbollistit të SC Gjilani, Mevlan Zeka.

Komisioni i veteranëve të futbollit vendosi që epiteti i yllit të javës për këtë javë t’i takojë futbollistit të SC Gjilani, pasi në ndeshjen kundër Dritës ishte një nga më të angazhuarit dhe tregoi lojë shumë të mirë. Përveç kësaj, ai realizoi edhe golin e barazimit nga penalltia, duke qenë më meritori që Gjilani mori një pikë në derbi.

Sulmuesi anësor i SC Gjilani u shpreh i lumtur që mori këtë çmim, derisa theksoi se skuadra e tij është afër arritjes së objektivave të këtij edicioni. “Kënaqësi e veçantë të shpallesh ‘Ylli i javës’, sidomos në ndeshjen derbi të qytetit, kur dihet rivaliteti i dy klubeve. Personalisht po kaloj në një formë të mirë te SC Gjilani dhe po e ndihmoj skuadrën drejt arritjes së objektivave, pasi tani jemi në finale të Kupës dhe shumë afër sigurimit të plasmanit në Evropë. Për formën time padyshim që duhet t’i falënderoj bashkëlojtarët dhe shtabin teknik, të cilët më kanë ndihmuar shumë. Ky çmim u dedikohet tifozëve ‘Skifterave’ të cilët, pavarësisht prej rrugëtimit tonë, e që nuk ka qenë i lehtë, na kanë qëndruar gjithmonë afër gjatë tërë vitit”, ka thënë Zeka për faqen zyrtare të FFK-së.




## Nura viziton portierin Gjokaj: Urojmë të kthehet edhe më i fortë

**Skenderaj, 15 maj** - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, e ka vizituar portierin e Drenicës, Altin Gjokaj, në shtëpinë e tij. Nura i ka uruar shërim të shpejtë dhe rikthim të fuqishëm portierit të Përfaqësueses së Kosovës U21. “Javë të mbarë! Nga vizita në shtëpinë e familjes mikpritëse të Altin Gjokajt, portierit të skuadrës së Drenicës dhe Kosovës U-21, me qëllimin për t’i uruar shërim të plotë, pas një lëndimi të frikshëm të papritur në fushën e futbollit, dhe me dëshirën që të kthehet më i fortë së kurrë te shokët e skuadrës!”, ka shkruar Nura në “Facebook”.



## Xavi: Për titull janë dashur 10 muaj punë dhe sakrificë e madhe

Barcelonë, 15 maj - Barcelona ka rikthyer titullin e kampionit në La Liga pas katër vjetësh. Katalunasit janë shpallur matematikisht kampionë katër xhiro para fundit të sezonit, ku kanë 85 pikë pas 34 ndeshjeve të zhvilluara. Pas triumfit, trajneri Xavi Hernandez ka thënë se është bërë një punë e mirë ku kanë kaluar 10 muaj me shumë sakrifica. "Ndjenjë e mrekullueshme. Një punë e bërë mirë. E gjithë kjo filloi korrikun e kaluar. Ishin 10 muaj punë dhe sakrifica. Tifozët dhe klubi e meritojnë. Titulli na jep stabilitet dhe besim se gjërat po shkojnë mirë. E vulosëm kampionatin me një ndeshje fantastike. Ne ishim të shkëlqyer", ka thënë Xavi. "Ekipi përfundimisht u qetësua dhe kundërshtarët u treguan krenarë. Ne fituam La Ligën në një derbi, që nuk është një gjë e zakonshme. Ishte një skenar i veçantë dhe ne e diskutuam para ndeshjes", ka deklaruar Xavi.



# KV Drita mbron titullin e kampiones

Gjilan, 15 maj - KV Drita është kurorëzuar me titullin e shtatë në histori të klubit, duke arritur fitore sensacionale me përmbysje në serinë e finaleve. Ndeshja e pestë, dhe e fundit e kësaj serie, solli një tjetër pasqyrë fenomenale të volejbollit, në palestrën e stërmbushur me mbi 3 500 spektatorë. Me një koreografi të veçantë dhe me praninë e tifozëve "Intelektualëve" dhe "Shqiponjat e zeza", spektakli ishte i garantuar.



Në hapje të ceremonisë, presidenti i FVK-së, Bahri Gjinovci, u shpërndau fanellat e Përfaqësueses së Kosovës në Volejboll kryetarit të Gjilanit, Alban Hyseni dhe drejtorit për sport në Skenderaj, Alban Berisha. Ndeshja nisi me rivalitet të jashtëzakonshëm dhe me ndryshime të shpeshta në epërsi, duke u konkretizuar me fitoren e Dritës 25:22. Setin e dytë Skenderaj e nisi më mirë. Skuadra nga Drenica madje pati epërsi të vazhdueshme në rezultat, e cila u humb befasisht në fazën e fundit të setit, falë një serie prej 6:0 të Dritës. Gjilanaset triumfojnë 25:22 edhe në setin e dytë. Pas epërsisë prej 2:0 të Dritës, Skenderaj s'kishte çka të humbte dhe shkoi me të gjitha forcat, por presioni psikologjik nga disavantazhi e bëri të veten, duke ngecur në gjysmën e dytë të setit të tretë. Drita e shfrytëzoi, duke avancuar deri në 8 pikë, e tendenca për rikthim e Skenderajt ishte vonë, duke u kufizuar në 21 pikë. Drita triumfoi në fund me pikën e fundit të këtij edicioni, që mbajti autorësinë e Venera Kadriut.

Në ceremoninë e ndarjes së çmimeve, medaljet për vendin e dytë u dhanë nga anëtari i bordit, Abedin Mehani, drejtori i Sportit në Skenderaj, Alban Berisha dhe nënkryetarja e Gjilanit, Leonora Morina Bunjaku.

Medaljet e arta u ndanë nga kryetari i Gjilanit, Alban Hysenj, nënkryetarja e FVK-së, Mimoza Shkodra Bislimi dhe sekretari i përgjithshëm i FVK-së, Valon Nikqi.

Kapitenes Adelajda Prenga trofeun ia dorëzoi presidenti i FVK-së, Bahri Gjinovci.

# Bostoni, finalisti i dytë në Konferencën e Lindjes

Boston, 15 maj - Bostoni është ekipi i dytë finalist i "play-off"-it në Konferencën e Lindjes, pas fitores 112-88 ndaj Philadelphias në ndeshjen e shtatë dhe të fundit gjysmëfinale. Skuadra e Celticsit fitoi 4-3 me ndeshje, duke siguruar kështu një biletë për në finalet e këtij kahu në NBA. Fitorja mban emrin e Jayson Tatumit, që realizoi 51 pikë, duke qenë në një mbrëmje magjike. Mirë u paraqit edhe borën me 25 pikë, ndërsa te Philadelphia zhgënjyen të gjithë lojtarët "big", përfshirë edhe Joel Embiidin, i shpallur MVP një javë më parë (15 pikë). Në finalet "play-off" të Konferencës së Lindjes, skuadra e Bostonit do të luajë ndaj Miami Heatit dhe do ta ketë në favor faktorin fushë. Të martën nisin ndeshjet finale në Konferencën e Perëndimit, ku Denveri pret në fushën e tij ekipin e lakersave.

| | | |
|---|---|---|
| **Konferenca e Lindjes, "Play-off" - Gjysmëfinale** | | |
| Boston - Philadelphia | 112-88 (4-3) | |
| New York - Miami | | (2-4) |
| **Konferenca e Lindjes, "Play-off" - Gjysmëfinale** | | |
| Boston - Miami | | |
| **Konferenca e Perëndimit, "Play-off" - Gjysmëfinale** | | |
| Denver - Phoenix | | (4-2) |
| Golden State - Lakers | | (2-4) |
| **Konferenca e Perëndimit, "Play-off" - Gjysmëfinale** | | |
| Denver - Lakers | | |




## SHKURT

### Laporta: Do të bëjmë gjithçka për ta rikthyer Messin

Presidenti i Barcelonës, Juan Laporta, i ka siguruar tifozët se do të bëjë gjithçka për ta rikthyer Lionel Messin në "Camp Nou" gjatë verës. Në deklaratat e tij në emisionin në "Twitter" "Jijantes", Laporta ka deklaruar se skuadra do të bëjë gjithçka për të rikthyer La Pulgën: "Do të bëjmë gjithçka që mundemi". Vlen të theksohet se gjatë festimeve për fitimin e titullit, tifozët e Barcelonës kanë brohoritur në mënyrë ritmike emrin e Messit.

### Pochettino këtë javë nënshkruan me Chelsean

Mauricio Pochettino së shpejti do të jetë në krye të gjigantit anglez Chelsea. Pas shkarkimit të Graham Potterit, "Blutë e Londrës" kanë qenë në kërkim të trajnerit të ri. Sipas raportimeve të fundit, londinezët tashmë kanë vendosur se cili trajner do ta udhëheqë ekipin e tyre nga qershori i këtij viti. Fabrizio Romano njofton që Mauricio Pochettino do të jetë në Londër këtë javë për ta nënshkruar kontratën si trajner i ri i Chelseas, që pritet të jetë e vlefshme deri në qershor 2026. Strategu argjentinas do të fillojë të diskutojë për planet e transferimit me klubin. Sulmuesi i ri dhe mesfushori i ri do t'i bashkohen Chelseat me siguri.

### Spalletti: Duhet ta kemi një skuadër konkurruese edhe në sezonin tjetër

Napoli i saposhpallur kampion në Serinë A u mund 0-2 nga Monza, një rezultat që nuk prish festën e skuadrës së trajnerit Luciano Spalletti. "Nuk ishim të përqendruar sa një javë më parë. Fitorja e titullit ndikoi, pasi lojtarët nuk dhanë atë që duhej të jepnin. Nuk ishim mjaftueshëm të motivuar", ka thënë Spalletti.

Gjithsesi, trajneri i Napolit mendon më shumë për të ardhmen, me shpresën që të ketë sërish një skuadër kompetitive si në Serinë A ashtu edhe në Evropë. "Tani që fituam titullin duhet të mendojmë për të ardhmen, për të pasur një skuadër konkurruese edhe në sezonin tjetër. Duhet të mendojmë që tani për ta sistemuar ekipin dhe jo të lëvizim në sekondën e fundit. Mendoj se i kemi të gjitha mundësitë për të bërë një skuadër kompetitive. Kemi disa futbollistë në shënjestër për të ardhmen. Shpresoj që klubi të lëvizë si duhet dhe shpejt, pasi kështu mund të jemi kompetitivë në të gjitha frontet", ka deklaruar Spalletti.

### Verstappaeni thumbon Hamiltonin: Russelli ka më shumë shanse për t'u shpallur kampion

Max Verstappen, dy herë kampion bote në Formula 1, shprehet se i trembet më shumë George Russellit se Lewis Hamiltonit, dy britanikët që pilotojnë makinën Mercedes. Holandezi beson se i riu britanik është më i aftë se 7 herë kampioni i botës dhe se me shumë gjasa do të shpallet kampion. "E njoh George që në garat kart dhe është mjaft i fortë. Për mendimin tim, ka potencialin e duhur për të qenë kampion bote në Formula 1 dhe mendoj se aktualisht ka më shumë shanse se Hamiltoni për t'ia dalë mbanë", u shpreh Max Verstappeni. "Unë shoh punët e mia te Red Bulli, por studioj edhe rivalët e mi e mendoj se Russelli e Leclercu janë dy rivalët e fortë të mi, bashkë me Perezin, natyrisht. Edhe Hamiltoni e Alonso janë kandidatë të fortë, por besoj se ka ardhur koha e të rinjve, që kanë më shumë guxim dhe dëshirë", u shpreh Verstappeni.

## Unitedi rikthen interesimin e Rabiotit

Adrien Rabiot do të jetë lojtar i lirë në fund të sezonit kur kontrata e tij me Juventusin të skadojë dhe "L'Equipe" raporton se Manchester Unitedi po përpiqet për të përfituar nga ky rast. 28-vjeçari deri më tani ka kontribuar me 11 gola dhe katër asistime në 43 paraqitje konkurruese për Juventusin këtë sezon, duke gjetur formën e tij në një rol më të avancuar nën drejtimin e trajnerit Max Allegri. Unitedi kishte qenë tashmë në bisedime të avancuara me Rabiot gjatë verës pasi diskutoi një tarifë transferimi me Juven, por nuk arriti të pajtohej me kushtet personale me nënën dhe agjenten e Rabiot, Veronique. U raportua se ata po kërkonin një pagë prej të paktën 10 milionë eurosh në sezon. Sipas "L'Equipe", klubi i Ligës Premiere është i përgatitur të tentojë përsëri, pasi Erik ten Hag është një admirues i francezit. Juventusi e mori Rabiotin si lojtar të lirë kur u largua nga Paris Saint-Germain në korrik 2019.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023); lidhur me nenin 29 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2023 si dhe Vendimit të Auditores së Përgjithshme Nr. 655, Zyra Kombëtare e Auditimit ri-shpall:

**KONKURS**
**për plotësimin e vendit të lirë të punës**

1. **Pozita:** **Zyrtar i lartë ligjor**
   **Numri i referencës:** ZLL/ZKA/02-04/23
   **Grada:** ZKA-B4
   **Numri i pozitave:** Një (1)
   **Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të pacaktuar

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Kontribuon për funksionim efikas dhe efektiv të departamentit në pajtim me objektivat individuale;
- Siguron ofrimin e këshillave profesionale, interpretimeve dhe mendime juridike për personelin e ZKA-së;
- Përgatitë rekomandime, opinione dhe interpretime ligjore për çështje të auditimit dhe çështje tjera nga mandati i ZKA-së;
- Propozon dhe merr pjesë hartimin e akteve juridike të ZKA-së, duke u kujdesur për përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi;
- Hulumton dhe analizon legjislacionin lidhur me mandatin ligjor të ZKA;
- Përcjellë ndryshimet dhe plotësimet e reja ligjore dhe informon personelin lidhur me to;
- Harton parashtresa dhe përfaqëson ZKA-në në procedura gjyqësore, ndërmjetësim dhe arbitrazh;
- Përcjellë praktikat legjislative ndërkombëtare lidhur me Institucionet Supreme të Auditimit;
- Analizon projekt aktet normative që janë në procedura konsultative dhe përgatitë komente lidhur me to, sipas rastit;
- Sipas autorizimit, merr pjesë në takimet punuese dhe dëgjimet publike në komisionet parlamentare, për diskutimin e çështjeve që ndërlidhen me mandatin e ZKA-së apo shqyrtimin e projektligjeve që janë në procedurë parlamentare;
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Drejtori i departamentit.

**Kualifikimet Themelore:**
- Diplomë fakulteti në shkencat juridike;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, preferohet përvojë të punës hulumtuese dhe analitike;
- Preferohet provimi i jurisprudencës.

**Shkathtësitë e kërkuara**:
- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

**Informata të përgjithshme për kandidatë:**
Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Procedura e Aplikimit:**
Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

**Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:**
- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.
Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **31.05.2023 ora 16.00.**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

**Shënim:**
Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalne Kancelarije Revizije Republike Kosova, kao i Člana 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 03/2021 o prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (izmenjeno i dopunjeno u Pravilniku (ZKA) Br. 01/2023); vezano sa Članom 29 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji radnih mesta, Godišnjem planu za regrutaciju za 2023. godine, kao i Odlukom Generalne revizorke br.655, Nacionalna Kancelarija Revizije ponovo objavljuje:

**KONKURS**
**za popunjavanje slobodnih radnih mesta**

1. **Pozicija:** **Visoki pravni službenik**
   **Referentni broj :** ZLL/ZKA/02-04/23
   **Rang:** ZKA-B4
   **Broj pozicija:** Jedna (1)
   **Trajanje imenovanja:** Na neodređeno vreme

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Doprinosi efikasnom i efektivnom radu odeljenja u skladu sa pojedinačnim ciljevima;
- Obezbeđuje davanje stručnih saveta, tumačenja i pravnih mišljenja za osoblje NKR-a;
- Priprema preporuke, mišljenja i pravna tumačenja za pitanja revizije i druga pitanja iz mandata NKR-a;
- Predlaže i učestvuje u izradi pravnih akata NKR-a, vodeći računa o njihovoj usklađenosti sa važećim zakonodavstvom;;
- Istražuje i analizira zakonodavstvo u vezi sa zakonskim mandatom NKR-a;
- Prati promene i nove zakonske dopune i o njima obaveštava zaposlene;
- Piše izlaganja i zastupa NKR u sudskim postupcima, posredovanju i arbitraži;;
- Prati međunarodnu zakonodavnu praksu u vezi sa vrhovnim revizorskim institucijama;
- Analizira nacrte normativnih akata koji su u konsultativnim procedurama i priprema komentare vezano sa njima, po slučaju;
- Prema ovlašćenju učestvuje na radnim sastancima i javnim raspravama u skupštinskim komisijama, radi razmatranja pitanja koja se vežu sa mandatom NKR-a ili razmatranja nacrta zakona koji su u skupštinskoj proceduri;
- Obavlja i druge poslove po nalogu direktora odeljenja.

**Osnovne kvalifikacije:**
- Fakultetska diploma pravnih nauka;
- Poželjno je sedam (7) godina profesionalnog radnog iskustva, istraživačkog i analitičkog radnog iskustva;
- Pravosudni ispit je poželjan.

**Potrebne veštine:**
- Znanje i iskustvo u izradi, usaglašavanju zakonskih i drugih pravnih akata;
- Poznavanje pravnih akata koji se sprovode u Nacionalnoj kancelariji revizije;
- Veština komunikacije i planiranja rada;
- Istraživačke, analitičke, evaluacione veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost ispunjavanja zadataka i rada pod pritiskom;
- Poznavanje rada na računaru softverskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Access, Internet

**Opšte informacije za kandidate:**
Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

**Procedura aplikacije:**
Procedura aplikacije je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna kancelarija revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i pozdravlja kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

**Kandidati trebaju predati sledeća potrebna dokumenta:**
- službeni formular NKR-a za aplikaciju;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti overene kod notara;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Penzionog fonda);
- svedočenje iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci)
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog funkcionera (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenta dostavljena nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpuna će biti odbijena. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.
Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (onlajn) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za podnošenje dokumentacije **31.05.2023** godine do **16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

**Beleška:**
Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

1Nr.464/01-57437/3
Datë: 10.05.2023

Në bazë të dispozitave të neneve 11,13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 10 të Ligji Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205,Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016,Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.20/21 Qershor 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

## VENDIM PRELIMINAR

**I.** PLOTËSOHET DHE NDRYSHOHET,Vendimi Preliminar 1Nr.464/01-57437/2 i datës 05.01.2023, të përshkrimit detaj të pjesës tabelare të parcelave kadastrale sipas Certifikatës-Njësisë kadastrale për shpronësim për rrugën "Bashkim Krasniqi" në Lipjan, përkatësisht në faqen nr .2 me nr rendor 8. fshihet parcela nr.01167-6 ZK Lipjan, ndërsa shtohen edhe dy parcela në faqen nr.3, me shënime dhe përmbajtje si vijon:

| K.K. Lipjan | | | | | K.K. Lipjan | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjendja e vjetër | | | | | Gjendja e re | | | | |
| Nr. | Pronar | Parcela kadastrale | Kultura-klasa | Sipërfaqe m² | Pronar | Parcela kadastrale | Kultura-klasa | Sipërfaqe e mbetur m² | Sipërfaqe për rrugë m² |
| 19 | Xhezahir (Nazif )Fazliu | P-71409044-02177-2 ZK Lipjan | Arë e Kl.1 | 1370 | Gjerëtanishmi | E Re | | 1367 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë lokale | | 3 |
| 20 | Nadica (Novica) Mcgee<br>Ninoslav Dejanovoiq | P-71409044-02177-1 ZK Lipjan | Arë e Kl.1 | 690 | Gjerëtanishmi | E Re | | 683 | |
| | | | | | Komuna e Lipjanit | KK Lipjan | Rrugë Lokale | | 7 |

**II.** Vendimi Preliminar hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërën nga gazetat ditore.

I'u dërgohet:
-të gjitha Drejtorive
-Arkivit të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PREDSEDNIK OPŠTINE

1Br.464/01-57437/3
Dana: 10.05.2023

Na osnovi stavova člana 11,13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službene Novine Republike Kosova , Br. 28 dt 4 Juni 2008, člana 4 i člana 10 zakona Br.03/L-139 Eksproprijaciju nepokretne Imovine, Službene Novine Republike Kosova, Br.52/08 Maj 2009 promene i dopune obavljene sa Zakonom Br.03/1-205, Službene Novine Republike Kosova, Br. Nr.91/10 Decembar 2010, stavova člana 83 Zakona za Opštu Administrativno Proceduri Br.05/L-031 Službene Novine Republike Kosova, Nr.20/21 Juni 2016, član 40 i 41 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt 24.12.2021, Predsednik Opštine Lipljan donosi:

## PRELIMINARNA ODLUKA

**I.** DOPUNUJE SE I PROMENUJE SE, Preliminarna Odluka 1Br.464/01-57437/2 dt. 05.01.2023, na detaljan opis katastarskih parcela prema Certifikat-katastarskoj jedinici za eksproprijaciju za ulicu „Bashkim Krasniqi" u Lipljanu, odnosno na strani broj .2 pod rednim brojem 8. parcela broj 01167-6 ZK Lipljan se briše, dok se na strani broj 3 dodaju još dve parcele, sa napomenama i sadržajem:

| K.K. Lipjan | | | | | K.K. Lipjan | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Staro Stanje | | | | | Novo Stanje | | | | |
| Br. | Vlasnik | Kadastralna Parcela | Kultura-klasa | Površina m² | Vlasnik | Kadastralna Parcela | Kultura-klasa | Ostatak površine m² | Površina za put m² |
| 19. | Xhezahir (Nazif) Fazliu | P-71409044-02177-2 ZK Lipjan | Njiva Kl.1 | 1370 | Dosadašnji | Novo | | 1367 | |
| | | | | | Opština Lipljan | S.O. Lipljan | Lokalni Put | | 3 |
| 20 | Dejanoviq Ninoslav Nadica (Novica) Mcgee | P-71409044-02177-1 ZK Lipjan | Njiva Kl.1 | 690 | Dosadašnji | Novo | | 683 | |
| | | | | | | S.O. Lipljan | Lokalni Put | | 7 |

**II.** Odluka stupa na snagu nakon objavljivanja na Službenom Novinu Republike Kosova i nakon objavljivanja u jednom od novina sa največim tiražom.

Dostavljen:
-svim Direkcijama
-Arhive Opštine

PREDSEDNIK OPŠTINE
Imri Ahmeti

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

Gjej PUNË
• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi
Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:
- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë


facebook
www.facebook.com/gjejpuneshpejte

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

PRISHTINA

**DREJTORIA E ARSIMIT**
**03-111/01-96959/23**
**Datë: 15.05.2023**

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit nr. Nr. 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 5 pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Drejtoria për Arsim në Komunën e Prishtinës:

**KONKURS**
**PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

**Titulli i vendit të punës:**

1. Drejtor/e në SHFMU "Asim Vokshi", Komuna e Prishtinës;
2. Drejtor/e në SHFMU "Dardania", Komuna e Prishtinës;
3. Zëvendësdrejtor/e në SHFMU "Dardania", Komuna e Prishtinës;
4. Drejtor/e në SHFMU "Elena Gjika", Komuna e Prishtinës;
5. Drejtor/e në SHFMU "Emin Duraku", Komuna e Prishtinës;
6. Drejtor/e në SHFMU "Gjergj Fishta", Komuna e Prishtinës;
7. Drejtor/e në SHFMU "Hasan Prishtina", Komuna e Prishtinës;
8. Zëvendësdrejtor/e në SHFMU "Hasan Prishtina", Komuna e Prishtinës;
9. Drejtor/e në SHFMU "Meto Bajraktari", Komuna e Prishtinës;
10. Zëvendësdrejtor/e në SHFMU "Meto Bajraktari", Komuna e Prishtinës;
11. Drejtor/e në SHFMU "Nazim Gafurri", Komuna e Prishtinës.
12. Drejtor/e në SHFMU "Pavarësia", Komuna e Prishtinës.
13. Drejtor/e në SHFMU "Shkolla e Gjelbër", Komuna e Prishtinës.
14. Drejtor/e në SHFMU "7 Marsi", Komuna e Prishtinës.
15. Drejtor/e në SHFMU "Mitrush Kuteli", Komuna e Prishtinës.
16. Drejtor/e në SHFMU "Pjetër Bogdan", Komuna e Prishtinës.
17. Drejtor/e në SHFMU "Ali Kelmendi", Komuna e Prishtinës.
18. Drejtor/e në SHFMU "Ismail Qemali", Komuna e Prishtinës.
19. Drejtor/e në SHFMU "Iliria", Komuna e Prishtinës.
20. Drejtor/e në SHFMU "Dituria", Komuna e Prishtinës.
21. Drejtor/e në SHFMU "Mehmet Gjevori", Komuna e Prishtinës.
22. Drejtor/e në SHFMU "Azemi e Salihu", Komuna e Prishtinës.
23. Drejtor/e në SHFMU "Avni Rrustemi", Komuna e Prishtinës.
24. Zëvendësdrejtor/e në SHFMU "Faik Konica", Komuna e Prishtinës;
25. Zëvendësdrejtor/e në SHFMU "Xhemajl Mustafa", Komuna e Prishtinës;
26. Zëvendësdrejtor/e në SHFMU "Andon Z. Çajupi", Komuna e Prishtinës;

**Institucioni:** **Komuna e Prishtinës**
**Drejtoria:** **Drejtoria për Arsim**
**Lloji i pozitës:** **Nëpunës i Shërbimit Publik**
**Titulli i mbikëqyrësit:** **Drejtoria e Arsimit**
**Kohëzgjatja e emërimit:** **Katër (4) vite;**

**Qëllimi i vendit të punës:** Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo-arsimor.

**1. Informata të përgjithshme**

1.1. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 15.05.2023 deri më datën 29.05.2023;
1.2. Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës rr. UÇK-2, 10000, Prishtinë.
1.3. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
1.4. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
1.5. Për qëllime të arkivimit, i tërë dokumentacioni që dorëzohet për aplikim si kopje fizike, gjithashtu duhet të jetë i skenuar dhe i vendosur në USB (USB-në mund ta merrni prapa pasi të përfundon konkursi);
1.6. Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
1.7. Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
1.8. Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë te aplikoj në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
1.9. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
1.10. Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse.

***Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.**

**2. Kushtet**

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

2.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
2.2. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm:
  2.2.1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
  2.2.2. Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
  2.2.3. Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
  2.2.4. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
2.3. Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve[1];
2.4. Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimet të KSHLM;
2.5. Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
  2.5.1. Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë;
  2.5.2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët/et për drejtor/eshës në nivele tjera, dhe
  2.5.3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendësdrejtor/eshë.
2.6. Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurron.[2]

**3. Dokumentet e kërkuara**

Kandidatët duhet të posedojnë dhe dëshmojnë dokumentet, si në vijim:
3.1. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
3.2. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
  3.2.1. Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve;
3.3. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
3.4. Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
3.5. Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët[3];
3.6. Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor[4];
3.7. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike[5];
3.8. Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës[6];

**4. Detyrat dhe përgjegjësitë për drejtorë**

Drejtori ka përgjegjësi ekzekutive ne□ menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm te□ institucionit, duke përfshirë:

4.1. Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor te□ institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore te□ punës;
4.2. Përdorimin efikas dhe efektiv te□ sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve te□ këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e te□ dhënave te□ nevojshme gjate□ vitit shkollor;
4.3. Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën ne□ institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera qe□ kane□ te□ bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë□ te□ arsimit;
4.4. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
4.5. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional te□ institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
4.6. Bashkëpunon me Këshillin drejtues të institucioni edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
4.7. Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;

[1] Nëse kandidati/ja është në proces të ri-licencimit, të dorëzojë dëshmi nga MASHT për këtë.
[2] Shihni UA 05/2015 Normativi për Mësimdhenesit e Arsimit Profesional

[3] Përpos dokumenteve të cekura në pikën 3.5, DKA Prishtinë do të kërkojë nga Inspektorati për Arsim nëse kandidatët që kanë konkurruar kanë raste të mbyllura apo të hapura kundër tyre.
[4] Shihni Formularin B/1 për kriteret e pikëzimit të dokumenteve, si dhe Formularin H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale.
[5] Shihni Formularin I - Model i Deklaratës nën Betim.
[6] Shihni Formularin H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale, por po ashtu Formularin B/1 rreth kritereve të pikëzimit të dokumenteve.

4.8. Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
4.9. Ruajtjen e dokumenteve dhe te dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);
4.10. Çështjet e tjera qe rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet qe dalin nga rregullorja e komunës per arsim.

5. **Detyrat dhe përgjegjësitë për zëvendësdrejtorë**

Zëvendësdrejtori i IEAAP ka përgjegjësi të mbështesë dhe ndihmojë punën e drejtorit për të siguruar administrimin dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor, si vijon:

5.1. Përkujdeset dhe përcjell mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe ndihmon në krijimin e klimës pozitive në institucionin shkollor;
5.2. Monitoron dhe mentoron mësimdhënësit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre;
5.3. Përpunon statistikat e suksesit të nxënësve dhe të dhënat tjera në periudha të caktuara;
5.4. Përgatitë raport periodik për mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor;
5.5. Kontrollon ditarët e klasës së paku njëherë në një periudhë mësimore dhe udhëzon mësimdhënësit për mbajtjen e shënimeve në mënyrën e duhur;
5.6. Ndihmon dhe përkrah mekanizmat e institucionit shkollor për menaxhimin e cilësisë së performancës së institucionit;
5.7. Zëvendëson mësimdhënësit në rastet kur mungojnë;
5.8. Pranon, kontrollon dhe sistemon përgatitjen e planeve mësimore të mësimdhënësve;
5.9. Zëvendëson dhe përfaqëson drejtorin/eshën e institucionit shkollor sipas nevojës;
5.10. Kryen detyra të tjera të caktuara nga drejtori/esha i/e institucionit shkollor, në pajtim me ligjin.

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës mbështeten në ligjet për arsim në fuqi, ato plotësohen edhe me akte të tjera nënligjore që rregullojnë aspekte të veçanta në arsimin parauniversitar në Kosovë.

6. **Informimi për qasje në planin zhvillimor të IEAA-së përkatëse**

Duke ditur se koncepti i Planit Zhvillimor të institucionit edukativ-arsimor përkatës është një prej pikave të përgatitjes së portofolios profesionale, në linkun e mëposhtëm gjeni Planet zhvillimore të IEAA-ve të Komunës të Prishtinës, si vijon: https://prishtinaonline.com/drejtorite/arsimit/planet-zhvillimore-ieea

Për çdo problematikë teknike në sigurimin e Planit Zhvillimor të IEAA-së përkatëse, mund të drejtoheni në Drejtorinë Komunale të Arsimit.

7. **Vegëzat elektronike**

Për të siguruar transparencë dhe barazi maksimale për të gjithë kandidatët, i inkurajojme te gjithë kandidatet qe t'i lexojne me kujdes te gjitha Shtojcat e listuara më poshtë. Këto shtojca janë pjesë përbërëse e procesit përzgjedhes nga Komisioni i emëruar.

**Shtojca 1 -Udhëzimi administrativ (MASH) NR.151/2020** për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Linku:
https://masht.rks-gov.net/udhezim-administra-tiv-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dhe-pergjegjesite-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dhe-aftesues-parauniversitar-ne-republiken-e/

**Shtojca 2- Shtojcat e UA 151/2020** - dukë perfshirë Forumularet të cilat janë kyçe për përgatitjen e kandidatëve, përkatësisht:

- Formulari B - Dokumentet e kërkuara sipas nenit 5 të këtij UA
- Formulari B/1 - Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor/zëvendësdrejtor të IEAAP në bazë të dëshmive të prezantuara me rastin e konkurimit
- Formulari C - Protokolli i Intervistimit
- Formulari H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale
- Formulari I - Model i Deklaratës nën Betim

Linku: https://masht.rks-gov.net/shtojca-e-ua-151-1-formularet-per-vlersimin-e-kandidatve-per-drejtor-dhe-zevendesdrejtor-te-iea/

**Shtojca 3 -Udhëzimi administrativ (MASH)** 05/2015 Normativi për Mësimdhenesit e Arsimit Profesional

Linku:
https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-05-2015-normativi-per-mesimdhenesit-e-arsimit-profesional/

**Shtojca 4 - Udhëzues për kandidatët për fazën e intervistës**
Qëllimi i këtij dokumenti është që të i jap disa informata kandidatëve rreth mbarëvajtjes së procesit të përzgjedhjes dhe rreth asaj se çka mund të presin kandidatët gjatë ditës së intervistave.

Linku:
https://prishtinaonline.com/uploads/1_udhezues_per_kandidatet_per_fazen_e_intervistes_per_kandidatet_ne_pozita_udheheqese_te_institucioneve_edukativo-arsimore_.docx.pdf

**Shtojca 5 - Dokument informues për vezhguesit e Komisioneve përzgjedhëse**

Për hir të transparencës maksimale për kandidatët, vëzhguesit si dhe qytetarët e interesuar, më poshtë gjeni shtojcen bazë e cila do të përdoret nga Komisoni gjatë punës së tyre, dhe që është në përputhje më UA151/2020.

Linku:
https://prishtinaonline.com/uploads/1dokumenti_informues_per_vezhguesit_e_komisioneve.pdf

---

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Departamenti për Burime Njerëzore

07/1-01 SAP-R/519/2023
Datë 12.05.2023

Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: 18/04/2023 me nr ref: DBN 07/025/2023**,** Policia e Kosovës:

## VAZHDON AFATIN E KONKURSIT

Të publikuar nga data 19.04.2023 deri me datë 12.05.2023 me nr reference 07/1-01 SAP-R/516/2023 për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit për të gjitha minoritetet (Serb, Boshnjak, Turq, Goran, Romë, Ashkali, Egjiptas, Kroat, Malazez, Maqedonas ).

**Titulli i vendit të punës: Zyrtar Policor**
**Vendi i punës : Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Veri**

Afati për paraqitjen e aplikacioneve vazhdohet për tetëmbëdhjetë (18) ditë duke filluar nga data
**13.05.2023** deri me datë **30.05.2023**.

**Vëmendje: Kriteret në konkurs mbeten të njëjta si dhe kandidatët të cilët kanë konkurruar në këtë konkurs nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri.**

Formularët për aplikim mund të merren në zyrat e personelit të drejtorive rajonale, në stacionet policore, ose të tërhiqen nga ueb faqja e PK-së: **www.kosovopolice.com.** Aplikacioni për konkurrim duhet të dorëzohet së bashku me kopjet e dëshmive të kërkuara personalisht në zyrën e personelit pranë drejtorive rajonale në Prishtinë, Mitrovicë Jugu, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë Veri dhe Gjakovë, çdo ditë pune prej **orës 09:00-15:00**.

---

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Uprava za Ljudske Izvore

07/1-01 SAP-R/519/2023
Datë 12.05.2023

Na osnovu Zakona o Policiji, poglavlje V, član 44, Zakona o radu br. 03/L-212,poglavlje II, član 8, Zakon o ravnopravnosti polova br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakona o zaštiti od diskriminacije Br. 05/L-021, član 7, Administrativno Uputstvo 01/2021 o Radnom Odnosu u Policiji Kosova, poglavlje III član 8, član 9, tačka 1 i 2, i usvajanjem Generalnog Direktora od 18/04/2023 pod br ref: DBN 07/025/2023**,** Policija Kosova:

## PRODUŽENJE ROKA KONKURSA

Objavljen od 19.04.2023 do 12.05.2023.godine, sa br. referencije 07/1-01 SAP-R/516/2023 za prijem policijskih službenika po prethodnim uslovima konkursa za sve manjine (Srbe, Bošnjake, Turaka, Goranaca, Roma, Aškalije , Egipćane, Hrvate , Crnogorce, i Makedonce).

**Naziv radnog mesta: Policijski službenik**
**Radno mesto: Regionalna Direkcija Mitrovica -Sever**

Rok za prijavu aplikacija produžava se za osamnaest (18) dana, počev od **13.05.2023. do 30.05.2023**. godine.

**Pažnja: Kriterijumi na konkursu ostaju isti, i kandidati koji su konkurisali na ovom konkursu ne moraju da se ponovo prijave .**

Formulare za apliciranje mogu se uzeti u kancelarijama osoblja Regionalnih Direkcija, u Stanicama Policije, ili da se preuzimaju iz ueb stranice PK-a: **www.kosovopolice.com.** Aplikacija za konkurisanje treba da se preda lično zajedno sa kopijama potrebnih dokaza u kancelariji osoblja Reginalne Direkcije Priština, Mitrovica Jugu, Peć, Prizren, Uroševac, Gnjilane, Mitrovica Sever i Djakovica, svakog radnog dana **od 09:00-15:00.časova.**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**

| | |
|---|---|
| **Pozita:** | Zyrtar/e i/e lartë për mbështetje të operimit të sistemeve të pagesave |
| **Departamenti:** | Sistemi i Pagesave |
| **Divizioni:** | Operimit të Sistemeve |
| **I raportōn:** | Udhëheqësit të Divizionit të Operimit të Sistemeve |
| **Grada:** | 5 |

**Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësive:**

- Kryen detyrat e parapara në kuadër të procedurave ditore të punës me Sistemet e Pagesave dhe Regjistrin e Llogarive Bankare;
- Angazhohet në realizimin e detyrave të parapara për mbështetje të përdoruesve të sistemeve;
- Bashkëpunon dhe koordinon me Departamentin e Teknologjisë Informative/BQK, në raste të ngritjes së problemeve të natyrës teknike/operacionale apo sistemore dhe zhvillimeve të reja;
- Bashkëpunon me kompanitë kontraktuese, në funksion të mirëmbajtjes së sistemeve, ngritjes (zhvillimeve shtesë) së funksioneve shtesë dhe testimeve të sistemeve ekzistuese;
- Ofron trajnime për pjesëmarrësit e rinjë dhe ndihmon në përgatitjen teknike për këta pjesëmarrës;
- Angazhohet në realizimin e detyrave për punë operuese në SPN për rastet e jashtëzakonshme dhe ofron zgjidhje teknike;
- Angazhohet në përgatitjen e dokumenteve (rregullore, manuale të përdorimit, udhëzime teknike, procedura, etj) për sistemet e DSP-së;
- Angazhohet në përgatitjen e raporteve, procedurave dhe standardeve të ndërlidhura me menaxhimin e rrezikut operacional;
- Duhet te jetë njoftuar me të gjitha funksionet e sistemeve të DSP-së, dhe angazhohet në realizimin e të gjitha detyrave dhe punëve që kërkohen lidhur me funksionimin e rregullt të tyre;
- Komunikon dhe koordinon aktivitetet me departamentet dhe divizionet tjera të BQK-së lidhur me kërkesat dhe nevojat që rrjedhin për mbarëvajtjen e operacioneve me sistemet e DSP-së;
- Komunikon dhe ofron konsultat sipas nevojës për pjesëmarrësit e sistemit të pagesave, si dhe për palët e treta;
- Monitoron dhe ofron zgjidhje për funksionet teknik që lidhen me sistemet e DSP-së, etj.
- Angazhohet në përcjelljen e zhvillimeve të reja në fushën e shërbimeve të pagesave në BE e më gjerë, në standardet e mesazheve financiare, si dhe në analizimin dhe propozime për avancimin e funksioneve të sistemeve të pagesave;
- Angazhohet në monitorimin e veglave të ndryshme teknike te ndërlidhura me sistemet e DSP, si dhe përgatitjen e skriptave për filtrim te raporteve te njëhershme nga baza e të dhënave;
- Sipas nevoje kryen punë të tjera të lidhura me sistemet që operohen në kuadër të DSP-së të deleguara nga mbikëqyrësi apo hierarkia me lartë apo me obligimet që rrjedhin në kuadër të përgjegjësive të DSP dhe BQK-së.

**Njohuritë e kërkuara:**

- Njohuri të avancuara mbi sistemet e pagesave dhe të mesazheve financiare;
- Njohuri të avancuara në mirëmbajtjen e aplikacioneve kompjuterike të pagesave;
- Njohuri mbi menaxhimin e rreziqeve operacionale;
- Shkathtësi në nxjerrjen e të dhënave statistikore nga sistemet, sipas nevojave dhe natyrës së punës;
- Njohuri të mirë të menaxhimit të drejtave të shfrytëzuesve në aplikacionet bankare; dhe
- Njohuri në mbrojtjen e aplikacioneve kompjuterike nga sulmet dhe dëmtimet e mundshme kibernetike.

**Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:**

- Diplomë universitare në fushën e IT-së, inxhinierisë, ekonomisë (në drejtimet menaxhment dhe informatikë apo banka dhe financa);
- Përvojë prej së paku tre (3) viteve me aplikacione kompjuterike në fushën e pagesave dhe/apo sistemeve financiare;
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë në administrimin dhe mbështetjen teknike të sistemeve të pagesave;
- Njohuri të avancuara të gjuhës angleze.

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **30 maj 2023.**
- Aplikimi mund të bëhet online (https://hris.bqk-kos.org) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**RASPISIVANJE KONKURSA ZA SLOBODNO RADNO MESTO**

| | |
|---|---|
| **Pozicija:** | Viši službenik za podršku rada platnih sistema |
| **Odeljenje:** | Platni sistem |
| **Odsek:** | Rad sistema |
| **Izveštava:** | Rukovodiocu Odseka za rad sistema |
| **Stepen:** | 5 |

**Opis dužnosti i odgovornosti:**

- Obavlja predviđene dužnosti u okviru dnevnih procedura rada sa platnim sistemima i Registrom bankarskih računa;
- Angažuje se na realizaciji predviđenih dužnosti za podršku korisnika sistema;
- Sarađuje i koordinira sa Odeljenjem za informacionu tehnologiju/CBK, u slučaju pojavljivanja problema tehničke/operativne ili sistemske prirode i novih dešavanja;
- Sarađuje sa kompanijama za izvođenje radova u funkciji održavanja sistema, pokretanja (dodatnih dešavanja) dodatnih funkcija i testiranja postojećih sistema;
- Pruža obuke novim učesnicima i pomaže u tehničkoj pripremi za ove učesnike;
- Angažuje se u realizaciji operativnih radnih zadataka u MPS za vanredne slučajeve i pruža tehnička rešenja;
- Angažuje se u pripremi dokumenata (pravilnika, priručnika za korišćenje, tehničkih uputstava, procedura itd.) za DSP sisteme;
- Angažuje se u pripremi izveštaja, procedura i standarda povezanih sa upravljanjem operativnim rizikom;
- Treba da bude upoznat sa svim funkcijama DSP sistema i da se angažuje na realizaciji svih dužnosti i poslova koji se traže vezano za njihovo redovno funkcionisanje;
- Komunicira i koordinira aktivnosti sa ostalim odeljenjima i odsecima CBK-a vezano za zahteve i potrebe koje proističu za odvijanje operacija sa DSP sistemima;
- Komunicira i daje savete po potrebi za učesnike platnog sistema, kao i za treće strane;
- Prati i daje rešenja za tehničke funkcije koje su povezane sa DSP sistemima i slično.
- Angažuje se u praćenju novih dešavanja u oblasti platnih usluga u EU i šire, u standardima finansijskih poruka, kao i u analiziranju i davanju predloga za unapređenje funkcija platnih sistema;
- Angažuje se na praćenju raznih tehničkih alata povezanih sa DSP sistemima, kao i pripremanju skripti za filtriranje jednokratnih izveštaja iz baze podataka;
- Prema potrebi, obavlja i druge poslove vezano za sisteme koji rade u okviru DSP-a koje mu prenosi nadređeni ili viša hijerarhija ili obaveze koje proističu u okviru odgovornosti DSP-a i CBK-a.

**Potrebna znanja:**

- Napredna znanja o platnim sistemima i finansijskim porukama;
- Napredna znanja u održavanju računarskih platnih aplikacija;
- Znanja o upravljanju operativnim rizicima;
- Veštine u dobijanju statističkih podataka iz sistema, prema potrebi i prirodi posla;
- Dobro poznavanje upravljanja korisničkim pravima u bankarskim aplikacijama; i
- Znanje u zaštiti računarskih aplikacija od mogućih sajber napada i oštećenja.

**Potrebne kvalifikacije i iskustvo:**

- Univerzitetska diploma u oblasti IT-a, inženjerstva, ekonomije (u smerovima menadžment i informatika ili banke i finansije);
- Iskustvo od najmanje tri (3) godine sa računarskim aplikacijama u oblasti plaćanja i/ili finansijskih sistema;
- Prednost imaju kandidati sa iskustvom u administriranju i tehničkoj podršci platnih sistema;
- Napredno znanje engleskog jezika.

**Svi kandidati treba da dostave sledeću dokumentaciju:**

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde se naglašava interesovanje za ovu poziciju;
- Potvrda o radnom iskustvu izdata od strane nadležne institucije/organizacije;
- Izveštaj iz Trusta koji potvrđuje vremenski period radnog iskustva;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju da budu zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom prebivalištu u Republici Kosovo.

**Postupak podnošenja aplikacija:**

- Zadnji rok za podnošenje aplikacija je **30 maj 2023.**
- Aplikacija se može podneti online (https://hris.bqk-kos.org) preko zvanične stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti uzet u razmatranje.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti sa zvanične stranice : www.bqk-kos.org
- **Nepotpuna dokumentacija neće biti uzeta u obzir. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company

TREPÇA

Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 15.05.2023 bënë shpallje publike:

**NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-23-07**

| | |
|---|---|
| Qëllimi i ofertës: | Dhënie me qira e një pjese të repartit elektro-puntoria në njësisë biznesore Industria Kimike. |
| Kriteret e Dhënies: | Çmimi më i lartë |
| Numri i ofertave të pranuara: | 1 (një) |

**ME KONTRATË SHPËRBLEHET**

Loti 1 Çmimi 250.00 €/Muaj – Grey Fiks

Kontratat janë paraparë të nënshkruhet me datën 18.05.2023 ora 10:00

**AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtarë**: *Trepça sh.a.* | | |
| **Adresa postare**: *Parku inustrial* | | |
| Qyteti: *Mitrovicë* | Kodi postarë: *40000* | Shteti: *Kosovë* |
| **Kontakti**: *Burim HAJDINI* | | Telefoni: *+383 (0) 28 538 050* |
| Email: *hajdini_b@hotmail.com* | | Faksi: *+383 (0) 28 539 202* |
| *www.trepcacorporation.com* | | |

*Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 te Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021.*

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "T Mobile Shop" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811302223.

- Milazim Maliqi B.I. emri Tregtar N.T.P. "Fitimi" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues 810455429.

- Gjemajl Kocinaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Anes Atallahu shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Faik Haskuka shpall te pavlefshme diplomën shmm " Luciano Motroni " Prizren.

- Oltion Texhbecaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl XI, XII Gymnazium Loyola Prizren.

- Blerta Statovci, shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Don Bosko" Prishtinë, nga viti I, II, III si dhe Diplomën.

- Brahim Ibishi shpall te pavlefshme dëftesat 1 deri 8 se shkollës fillore ''Sefedin Smakolli.

- Mentori B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 601640726.

- Afrim Smjali shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ''Arkitekt Sinani''.

- Autoservis Beni-VW AUDI-VAG shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 80273029.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

